



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

RAPORTI VJETOR 2025

PËRMBAJTJA

04

PJESA I - INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

06

FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE DHE E DREJTORIT MENAXHUES

08

AKRONIMET

09

PORTOFOLI DHE IMPAKTI

10

PJESA II - PROFILI I INSTITUCIONIT

12

THEMELIMI DHE STATUSI I FKGK-SË

12

MISIONI DHE VIZIONI

13

VLERAT INSTITUCIONALE

14

SYNIMET E FKGK-SË

15

KONTRIBUTI I FKGK-SË NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

18

PJESA III - QEVERISJA KORPORATIVE

20

BORDI I DREJTORËVE

21

PERSONELI

22

STRUKTURA ORGANIZATIVE

23

BORDI I DREJTORËVE – FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË

23

KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE

24

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE

26

PJESA IV - BASHKËPUNËTORËT E FKGK-SË

28

DONATORËT

28

BASHKËPUNËTORËT

29

INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE PARTNERE

30

AECM

32

PJESA V - TË ARRITURAT OPERACIONALE TË FKGK-SË

35

ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE

36

KOMPONENTA FINANCIARE - DRITARET GARANTUESE TË FKGK-SË

43

KOMPONENTA JOFINANCIARE

44

SHTUESHMËRIA

47

ANGAZHIMET ME PALËT E INTERESIT GJATË VITIT 2025

49

MENAXHIMI I RREZIKUT

51

CILËSIA E PORTOFOLIT

53

RREZIKU OPERACIONAL

54

RREZIKU I REPUTACIONIT

55

KËRKESAT PËR PAGESË DHE RIKUPERIMET NGA KREDITË E DËSHTUARA

58

FINANCAT, THESARI DHE ADMINISTRATA

58

STRUKTURA E KAPITALIT

60

MENAXHIMI I FINANCAVE DHE KONTROLLI

61

INVESTIMI NË BURIME NJERËZORE

62

KORNIZA LIGJORE, RREGULLATIVE DHE E PAJTUESHMËRISË

65

QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE

68

PJESA VI -

AKTIVITETET E KOMUNIKIMIT DHE RELACIONEVE ME PUBLIKUN GJATË VITIT 2025

80

STORIE TË SUKSESIT

82

PJESA VII

83

PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

PJESA I





INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE DHE E DREJTORIT MENAXHUES

Të nderuar lexues,

Viti 2025 ishte një vit i rezultateve të rëndësishme dhe zhvillimit të mëtijshëm për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). Ai do të mbetet një pikë referimi në rrugëtimin e institucionit, duke shënuar **arritjen e mbi 1 miliard euro** kredive të garantuara që nga fillimi i operimit. Njëkohësisht, ky vit u karakterizua nga avancimi i dritareve garantuese, zgjerimi i portofolit aktiv garantues dhe forcimi i mëtijshëm i rolit të FKGK-së si një institucion kyç në mbështetje të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Kjo arritje nuk përfaqëson vetëm një rezultat sasior; ajo dëshmon se skema e garancisë kreditore e FKGK-së është konsoliduar si një instrument efektiv për mobilizimin e kapitalit privat, lehtësimin e investimeve dhe përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Që nga themelimi i tij, FKGK u krijua me një mandat të qartë: të përmirësojë qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare dhe duke nxitur investimet në sektorin privat. Sot, ky mandat mbetet po aq aktual, ndërsa roli ynë ka evoluar përtej ofrimit të garancive kreditore. FKGK është shndërruar në një partner të rëndësishëm zhvillimor që mobilizon kapital privat, nxit investimet dhe mbështet rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së Kosovës.

Në bashkëpunim të ngushtë me Institucionet e Regjistruara Financiare, Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe partnerët tanë ndërkombëtarë zhvillimorë, FKGK ka vazhduar të mbështesë investimet, konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e ndërmarrjeve kosovare. Gjatë vitit 2025, FKGK lëshoi garanci në vlerë prej 121 milionë euro, duke mbështetur kredi në vlerë prej

242.5 milionë euro për 3,111 ndërmarrje. Si rezultat, portofoli aktiv i garancive arriti në 179.5 milionë euro, ndërsa vlera kumulative e kredive të garantuara tejkaloi për herë të parë 1 miliard euro. Këta tregues nuk pasqyrojnë vetëm rritjen e aktivitetit të Fondit, por edhe besimin që Institucionet e Regjistruara Financiare, bizneset dhe partnerët tanë zhvillimorë kanë ndërtuar ndër vite ndaj skemës së garancisë kreditore të FKGK-së.

Gjatë vitit 2025, një fokus i veçantë iu kushtua avancimit të dritareve garantuese që adresojnë segmentet me prioritet zhvillimor, duke i përshtatur ato me nevojat e shoqërisë sonë dhe objektivat strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, Dritarja GROW u avancua ndjeshëm. Përqindja maksimale e garancisë u rrit nga 50% në 70%, ndërsa vlera maksimale e garancisë u dyfishua nga 500 mijë euro në 1 milion euro. Këto ndryshime krijojnë kushte më të favorshme për financimin e investimeve në energjinë e ripërtëritshme dhe masat e efikasitetit të energjisë për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, duke mbështetur tranzicionin e sektorit privat drejt një ekonomie më të gjelbër, më të qëndrueshme dhe më konkurruese.

Po aq të rëndësishme ishin edhe përmirësimet në Dritaren për Gratë në Biznes dhe Dritaren për Start-up, ku u ulën tarifat e garancisë për të lehtësuar qasjen në financim për ndërmarrjet e udhëhequra nga gratë dhe sipërmarrësit e rinj. Paralelisht, FKGK dhe Institucionet e Regjistruara Financiare intensifikuan aktivitetet e përbashkëta të promovimit dhe informimit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për këto produkte dhe zgjerimin e numrit të bizneseve përfituese.

Megjithatë, përmirësimi i dritareve garantuese është vetëm një pjesë e misionit tonë.

Objektivi ynë është që përfitimet e krijuara nga këto përmirësime të transferohen në mënyrë sa më efektive tek përfituesi i fundit – ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Kjo nënkupton që garancitë kreditore të reflektohen në kushte më të favorshme kreditimi, kërkesa më fleksibile për kolateral, maturitete më të gjata, kosto më të ulët të financimit dhe mundësi më të mëdha investimi. Prandaj, gjatë vitit 2025 FKGK dhe Institucionet e Regjistruara Financiare forcuan bashkëpunimin në promovimin dhe komunikimin e dritareve garantuese, me synim që përfitimet e tyre të kuptohen më mirë dhe të transferohen në mënyrë më efektive tek bizneset. Besojmë se ndikimi i një garancie kreditore nuk përcaktohet vetëm nga mbulimi i rrezikut, por edhe nga aftësia për t'i përkthyer këto përfitime në kushte më të favorshme financimi. Prandaj, synimi ynë është që Institucionet e Regjistruara Financiare ta shohin skemën e garancisë kreditore jo vetëm si një instrument të menaxhimit të rrezikut, por edhe si një mekanizëm zhvillimor që krijon vlerë për ekonominë, duke nxitur investimet, rritjen dhe konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve kosovare.

Rritja e vazhdueshme e portofolit garantues, zgjerimi i bashkëpunimit me Institucionet e Regjistruara Financiare dhe cilësia e lartë e portofolit dëshmojnë pjekurinë institucionale të FKGK-së. Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut, qeverisja e mirë korporative dhe qëndrueshmëria financiare kanë bërë që Fondi të konsolidohet si një nga institucionet më të besueshme të financimit zhvillimor në vend.

Asnjë prej këtyre rezultateve nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe partneritetin e vazhdueshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, partnerëve tanë ndërkombëtarë zhvillimorë dhe Institucioneve të Regjistruara Financiare. Mirënjohjen tonë të sinqertë ua shprehim të gjithë partnerëve për besimin, mbështetjen strategjike dhe kontributin e tyre në forcimin e kapaciteteve të Fondit dhe zgjerimin e qasjes në financa për bizneset kosovare.

AGAN AZEMI

KRYESUES I BORDIT TË DREJTORËVE

Mirënjohje të veçantë u shprehim punonjësve të FKGK-së, profesionalizmi, integriteti dhe përkushtimi i të cilëve kanë qenë themeli i suksesit dhe zhvillimit të institucionit gjatë dekadës së parë të operimit.

Ndërsa hyjmë në vitin e dhjetë të operimit, vizioni ynë mbetet i qartë: të zgjerojmë dhe lehtësojmë më tej qasjen në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të pasurojmë dritaret ekzistuese garantuese dhe të zhvillojmë instrumente të reja të ndarjes së rrezikut kreditor. Në këtë mënyrë synojmë të thellojmë partneritetin me sektorin financiar dhe të mbështesim investimet që rrisin produktivitetin, inovacionin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë së Kosovës.

Në fund të fundit, misioni ynë nuk është vetëm të garantojmë kredi. Misioni ynë është të krijojmë mundësi që bizneset të investojnë, të rriten, të inovojnë dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Pikërisht me këtë qasje besojmë se suksesi i FKGK-së nuk matet vetëm me vlerën e garancive të lëshuara, por me ndikimin që ato krijojnë në ekonomi dhe në jetën e ndërmarrjeve që mbështesim.

Viti 2025 dëshmoi edhe një herë se FKGK nuk është vetëm një mekanizëm i garancive kreditore. Ai është një partner zhvillimor që ndërton besim, mobilizon kapital privat dhe krijon ura ndërmjet sektorit financiar dhe sipërmarrjes. Në vitet që vijnë do të vazhdojmë ta forcojmë këtë rol, duke rritur ndikimin zhvillimor të çdo garancie dhe duke mbetur një partner i besueshëm për bizneset, Institucionet e Regjistruara Financiare dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Ju ftojme të vazhdoni leximin e këtij Raporti Vjetor, ku prezantohen në mënyrë të detajuar aktivitetet, rezultatet dhe performanca financiare e FKGK-së gjatë vitit 2025.

BESNIK BERISHA

DREJTOR MENAXHUES

AKRONIMET

AECM	ASOCIACIONI EVROPIAN I INSTITUCIONEVE GARANTUESE
ABRK	AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS
ASK	AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
BD	BORDI I DREJTORËVE
BE	BASHKËSIA EUROPIANE
BQK	BANKA QENDRORE E KOSOVËS
EIB	BANKA EVROPIANE PËR INVESTIME
EIF	FONDI EVROPIAN PËR INVESTIM
FKGK	FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
GROW	DRITARJA E MUNDËSIVE PËR RIMËKËMBJE TË GJELBËR
IF	INSTITUCIONI FINANCIAR
IFJB	INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE
IPF	INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE
IRF	INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE
IFRS	STANDARDI NDËRKOMBËTAR PËR RAPORTIM FINANCIAR
IMF	INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE
KA	KOMITETI I AUDITIMIT
KfW	BANKA ZHVILLIMORE GJERMANE
KJP	KREDITË JOPERFORMUESE
KMR	KOMITETI PËR MENAXHIM TË RREZIKUT
MCC	KORPORATA E SFIDAVE TË MILENIUMIT
MFPT	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE
MFK	FONDACIONI I MILENIUMIT TË KOSOVËS
MINTI	MINISTRIA E INDUSTRISË NDËRMARRËSISË TREGTISË DHE INOVACIONIT
NMVM	NDËRMARRJE MIKRO TË VOGLA DHE TË MESME
NIF	NUMRI IDENTIFIKUES I FERMERIT
OZHQ	OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM
PFSF	PROJEKTI PËR FUQIZIMIN E SEKTORIT FINANCIAR
PMMS	POLITIKA E MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
PRE	PAKO E RIMËKËMBJES EKONOMIKE
QMS	QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE
QRK	QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SIDA	AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
SMMS	SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL
USAID	AGJENCIA AMERIKANE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

PORTOFOLI DHE IMPAKTI

KAPITALI

109,234,599
EURO

SHUMA KUMULATIVE E
KREDIVE TË MIRATUARA

1,041,620,812
EURO

SHUMA KUMULATIVE E
GARANCIVE TË MIRATUARA

535,344,214
EURO

GARANCIONE TË REJA

121,010,358 EURO
+43% krahasuar me 2024

BILANCI I GARANCIVE

179,480,299 EURO
+32% krahasuar me 2024

GARANCIA MESATARE PËR KREDI

25,750 EURO
+7% krahasuar me 2024

TARIFA MESATARE
E PONDERUAR E
GARANCISË NË
KREDI TË REJA

1.16%
-0.20 pp krahasuar me 2024

RFI
PARTNERE

12

NUMRI I KREDIVE
TË GARANTUARA

20,790

KREDI AKTIVE
TË GARANTUARA

8,208

BIZNESE TË
GARANTUARA
(PËRFSHIRË NIF)

12,767

VENDE TË REJA
PUNË TË KRIJUARA
INDIREKT

34,112

CILËSIA E PORTOFOLIT

KËRKESAT PËR PAGESË
NGA KREDITË E DËSHTUARA

4,716,278
2.6% e portofolit aktiv

KREDI JO PERFORMUESE

1.39%
-0.8 pp

RAPORTI RUKUPERIM/
KËRKESË PËR PAGESË NGA
KREDITË E DËSHTUARA

11.6%

KOHA E PROCESIMIT TË
KËRKESËS PËR PAGESË PËR
KREDINË E DËSHTUAR

7 ditë

PJESA II





PROFILI I INSTITUCIONIT



THEMELIMI DHE STATUSI I FK GK-SË

Fondi Kosovari për Garanci Kreditore (FKGK) është një institucion publik i pavarur dhe zhvillimor, i themeluar me Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e FK GK-së, i cili ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016. Ligji mbi themelimin e FK GK-së është sponsorizuar nga MTI-ja, me përkrahje të USAID-it përmes programit "Fuqizimi i mbështetjes kreditore" dhe Bankës Zhvillimore Gjermane (KfW). Ligji për FK GK-në ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016, ndërsa aktivitetin operacional institucioni i FK GK-së e ka nisur në muajin shtator të të njetit vit.

FKGK gëzon statusin e subjektit juridik të pavarur dhe funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, dhe ka autonomi operative dhe financiare në ushtrimin e mandatit të tij. Mandati kryesor i FK GK-së është të lehtësojë

qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë, përmes ofrimit të garancioneve kreditore për institucionet financiare të licencuara. Në këtë mënyrë, FK GK nuk jep kredi apo grante, por ndan rrezikun me institucionet financiare partnere, duke mundësuar rritjen e kreditimit në sektorin privat. Si institucion zhvillimor, FK GK kontribuon në forcimin e sektorit financiar, nxitjen e investimeve private dhe mbështetjen e rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës në Kosovë.

FKGK qeveriset nga Bordi i Drejtorëve, i cili mbikëqyr drejtimin strategjik dhe funksionimin e institucionit. Veprimtaria e FK GK-së bazohet në parimet e transparencës, llogaridhënies, qëndrueshmërisë financiare dhe qeverisjes së mirë korporative.

MISIONI DHE VIZIONI

Fondi Kosovari për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me orientim zhvillimor, i cili mbështetë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, duke ofruar garanci kreditore për institucionet financiare kredituese.

Me dritaret tona garantuese synojmë të krijojmë një klimë të favorshme për investime, duke

u përqendruar në mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë vendase dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ne jemi të përkushtuar ndaj një menaxhimi korporativ të qëndrueshëm dhe përgjegjësisë sociale, duke bashkëpunuar me donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët vendor për të shërbyer interesave afatgjatë të ekonomisë, biznesit dhe shoqërisë në përgjithësi.

VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat tona institucionale formësojnë kulturën tonë të punës dhe drejtojnë praktikën tonë të përditshme, duke na udhëhequr drejt një niveli të lartë përgjegjshmërie, në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale.

VLERAT TONA THEMELORE:

TRANSPARENCA

KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI I HAPUR

PAVARËSIA INSTITUCIONALE DHE VENDIMMARRJA

PËRKUSHTIMI DHE ETIKA PROFESIONALE

AVANCIMI I VAZHDUESHËM I DRITAREVE GARANTUESE

PËRGJEGJËSIA SOCIALE DHE GJITHPËRFSHIRJA

TRANSPARENCA

FKGK, si një institucion me interes publik, e konsideron jashtëzakonisht të rëndësishme transparencën dhe shpalosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, aktivitetet, si dhe rezultatet financiare e operative, ndaj partnerëve, palëve të interesit dhe publikut të gjerë.

KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI I HAPUR

Si në marrëdhëniet ndërmjet kolegëve brenda institucionit, ashtu edhe me partnerët tanë, është një vlerë e kultivuar me kujdes, e cila na udhëheq në përmbushjen e objektivave institucionale dhe realizimin e tyre. Nepërpiqemi të përcjellim në mënyrë të hapur parimet dhe objektivat e institucionit tonë të partnerët e jashtëm, duke i jetësuar këto parime edhe në marrëdhëniet e përditshme mes kolegëve brenda institucionit. Vetëm në këtë mënyrë, përmes sinjeralitetit të ndërsjellë dhe komunikimit të hapur, besojmë se mund të ndërtojmë një besueshmëri të qëndrueshme dhe një harmoni mes interesave institucionale dhe atyre personale.

PAVARËSIA INSTITUCIONALE DHE VENDIMMARRJA

Si një institucion i pavarur dhe autonom, i themeluar me ligj të veçantë, ne përpiqemi ta kultivojmë dhe ta ruajmë pavarësinë institucionale, si në procesin e vendimmarrjes strategjike dhe operacionale, ashtu edhe në përgjegjshmërinë ndaj rezultateve dhe pasojave që burojnë prej saj. Bordi i Drejtorëve dhe stafi i FKGK-së besojnë se pavarësia profesionale, e shoqëruar me llogaridhënie transparente dhe të bazuar në parime të shëndosha, është një parakusht thelbësor për ndërtimin e profesionalizmit, besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë institucionale.

PËRKUSHTIMI DHE ETIKA PROFESIONALE

Stafi dhe Bordi i Drejtorëve të FKGK-së besojnë fuqishëm në rolin dhe ndikimin pozitiv që ky institucion ka në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies sociale në vendin tonë. Ne udhëhiqemi nga parimet më të larta etike dhe morale, duke vepruar me ndershmëri, transparencë, integritet dhe profesionalizëm në punën tonë. Përmes respektimit të këtyre vlerave, ne ruajmë besimin dhe marrëdhëniet e forta me partnerët dhe palët e interesit, duke kontribuar në ndërtimin e një kulture të besueshmërisë dhe përgjegjshmërisë.

AVANCIMI I VAZHDUESHËM I DRITAREVE GARANTUESE

Ne inkurajojmë inovacionin dhe përpiqemi vazhdimisht të përmirësojmë shërbimet tona, duke u angazhuar në mënyrë proaktive për të përmbushur kërkesat e ndryshme të tregut dhe nevojat specifike të ndërmarrësve privatë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE DHE GJITHPËRFSHIRJA

Me dritaret garantuese, FKGK është e përkushtuar të kontribuojë pozitivisht në shoqëri, duke ndjekur parimet e përgjegjësive sociale dhe mbështetur ndërmarrjet private që, përmes investimeve të tyre, kujdesen të mos dëmtojnë mjedisin ku jetojmë, ndërsa njëkohësisht promovojnë gjithëpërfshirjen dhe ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë, bindjeve apo përkatësisë kombëtare dhe fetare.

SYNIMET E FKGGK-së

FKGGK fokusohet në zgjerimin e qasjes në financa, mbështetjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke fuqizuar sektorët me potencial, promovuar inovacionin dhe forcuar qëndrueshmërinë institucionale.

QASJA NË FINANCA

Gratë në Biznes
Ndërmarrësit e rinj
Ekonomia e Gjelbër/E Qëndrueshme
Fermerët
Sektorët më pak të shërbyer
Përfshirja ekonomike e Diasporës

RRITJA EKONOMIKE

Nxitja e prodhimit dhe eksportit
Nxitja e formalizimit të biznesit
Nxitja e krijimit të vendeve të reja të punës
Promovimi i Inovacionit

EFEKTI KUNDËRCIKLIK NË KOHË KRIZE

Përmes skemave garantuese, përpiqen të zbuten efektet negative në periudha të rënies ekonomike.

QËNDRUESHMËRIA INSTITUCIONALE

Qëndrueshmëria financiare
Promovimi i praktikave më të mira për të zbutur rrezikun kreditor
Procese të brendshme efikase dhe të qëndrueshme
Institucioni i pavarur i mirë-formuar me integritet të lartë
Stafi profesional
Trajnime dhe avancim i vazhdueshëm i shkathtësive të stafit

KONTRIBUTI I FKGGK-së NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Në partneritet me IRF-të, donatorët, partnerët zhvillimorë dhe institucionet publike, FKGGK kontribuon në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) përmes zgjerimit të qasjes në financa, mobilizimit të investimeve private dhe mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

OZHQ 5: BARAZI GJINORE

SYNIMET

Të rritet qasja në financa për gratë ndërmarrëse.

Të zvogëlohen barrierat financiare dhe kërkesat për kolateral për bizneset në pronësi të grave.

Të fuqizohen gratë përmes ngritjes së kapaciteteve dhe edukimit financiar.

REZULTATET KRYESORE

5 BARAZI
GJINORE



1,914 biznese në pronësi të grave janë mbështetur përmes garancive kreditore.

15% e kredive të garantuara janë disbursuar për gratë ndërmarrëse.

657 gra ndërmarrëse janë trajnuar përmes komponentës jofinanciare.

30% e kredimarrësve për herë të parë janë biznese në pronësi të grave.

76% e stafit të FKGGK-së janë gra.

OZHQ 8: PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE

SYNIMET

Të rritet qasja në financa për NMVM-të.

Të mbështetet krijimi dhe ruajtja e vendeve të punës.

Të promovohet formalizimi i ndërmarrjeve dhe rritja ekonomike.

Të mobilizohet kapital privat për investime produktive.

REZULTATET KRYESORE

8 PUNË DINJITOZE DHE
RITJE EKONOMIKE



11,607

11,607 biznese janë mbështetur përmes garancive kreditore. Kjo përfaqëson rreth 22% të bizneseve aktive në Kosovë.

34,112 vende pune të projektuara të mbështetura nga bizneset përfituese.

1.04 miliardë euro kredi janë mobilizuar për ekonominë.

OZHQ 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË

SYNIMET

Të nxitet modernizimi teknologjik dhe produktiviteti i NMVM-ve.

Të mbështeten investimet në prodhim dhe infrastrukturë.

Të promovohet konkurrueshmëria dhe orientimi drejt eksportit.

Të lehtësohet financimi afatgjatë për investime kapitale.

REZULTATET KRYESORE

9 INDUSTRI, NOVACION DHE INFRASTRUKTURË



40%

e kredive janë dedikuar për teknologji, makineri dhe infrastrukturë.

39 muaj

maturitet mesatar i ponderuar, krahasuar me maturitetet më të shkurtra të tregut.

203.3 milionë euro kredi janë dedikuar sektorit të prodhimit.

28%

e financimit të sektorit të prodhimit është garantuar nga FKGK.

46.9

milionë euro kredi janë dedikuar ndërmarrjeve eksportuese.

58.3%

e financimit për eksport është orientuar në sektorin e prodhimit.

OZHQ 10: ZVOGËLIM I PABARAZIVE

SYNIMET

Të përmirësohet përfshirja financiare e grupeve të nënshërbyera.

Të zvogëlohen pabarazitë rajonale në qasje në financa.

Të promovohet qasje më e barabartë në financa.

REZULTATET KRYESORE

10 ZVOGËLIM I PABARAZIVE



95%

e kredimarrësve për herë të parë në sektorin bankar janë mbështetur nga FKGK.

62%

e kredive të garantuara janë shpërndarë jashtë rajonit të kryeqytetit.

30%

e kredive mbi 100 mijë euro janë lëshuar pa kolateral.

OZHQ 13: VEPRIM PËR KLIMËN

SYNIMET

- Të mbështetet tranzicioni drejt ekonomisë së gjelbër.
- Të promovohet energjia efiçiente dhe energjia e ripërtrishme.
- Të reduktohen emetimet e karbonit përmes investimeve të gjelbra.
- Të rritet financimi për projekte me ndikim pozitiv mjedisor.

REZULTATET KRYESORE

13 VEPRIM PËR KLIMËN



6,279 tonë CO₂/vit reduktim i emetimeve.

10,515 MWh/vit kursime të energjisë primare.

Financimi i investimeve në energji të ripërtëritshme, efikasitet energjetik dhe teknologji të pastra.

OZHQ 17: PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

SYNIMET

- Të forcohen partneritetet me sektorin financiar.
- Të mobilizohen burime financiare shtesë për zhvillim.
- Të forcohet bashkëpunimi me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Të sigurohet qëndrueshmëria institucionale dhe financiare e FKGK-së.

REZULTATET KRYESORE

17 PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT



109 milionë euro kapital i zotuar.

1.04 miliardë euro kapital privat i mobilizuar.

12 institucione financiare partnere.

8 donatorë dhe partnerë zhvillimorë.

PJESA III





QEVERISJA KORPORATIVE

Qeverisja korporative e FK GK-së bazohet në parimet e transparencës, llogaridhënies, integritetit dhe efikasitetit institucional, duke siguruar një strukturë të qartë vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse për realizimin e mandatit dhe objektivave strategjike të institucionit. Organet e FK GK-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues së bashku me personelin.

BORDI I DREJTORËVE

FK GK-ja qeveriset nga Bordi i Drejtorëve në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:

- A. një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës
- B. një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
- C. katër (4) anëtarë të pavarur, të zgjedhur nga donatorët dhe
- D. Drejtori Menaxhues i FK GK-së, sipas detyrës zyrtare.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të FK GK-së në vitin 2025:

**AGAN
AZEMI**
KRYESUES I BORDIT
TË DREJTORËVE TË
FK GK-së



**KRESHNIK
KURTISHI**
ANËTAR I PAVARUR
I BORDIT



**ANILA
STATOVCI DEMAJ**
ANËTARE E PAVARUR
E BORDIT



**MELIH
ÇADIRCI**
ANËTAR I PAVARUR
I BORDIT



**BESNIK
BERISHA**
DREJTOR
MENAXHUES
I FK GK-së



**ZEF
DEDAJ**
ANËTAR I BORDIT
SIPAS DETYRËS
ZYRTARE - MINTI



* Mandati i përfaqësuesit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës në Bordin e Drejtorëve ka skaduar më 12 qershor 2024 dhe ende nuk është emëruar përfaqësuesi i ri.

PERSONELI

Ekipi i FKKG-së në vitin 2025:

**ALBAN
RAMADANI**

MENAXHER I NJËSISË SË
MENAXHIMIT TË RREZIKUT



**ALBULENA
LUBISHTANI**

SPECIALISTE E LARTË
PËR PROJEKTE



ANITA TOÇI

SPECIALISTE E LARTË
PËR KOMUNIKIM DHE
RELACIONE ME PUBLIKUN



AULONA SELISHTA

SPECIALISTE PËR RAPORTIM,
MENAXHIM TË TË DHËNAVE
DHE ANALIZË PORTOFOLI



**BESA
JASHARI**

SPECIALISTE PËR KËRKESAT
PËR PAGESA DHE RIKTHIME



**BESNIK
BERISHA**

DREJTOR MENAXHUES



**BURBUQE
GURI**

SPECIALISTE
E KONTROLLIT



**ENISA
BASHOTA**

SPECIALISTE E LARTË
E RREZIKUT



**JEHONA
GJERGJI**

ZYRTARE LIGJORE



**LIRIDONA
SOPA**

SPECIALISTE
PËR FINANCA



**MAHIR
BLAKU**

SPECIALIST I LARTË I RREZIKUT



MRIKA MALIQI

SPECIALISTE PËR QEVERISJE
MJEDISORE DHE SOCIALE

*deri më 15.11.2025



NORA ARIFI

MENAXHERE E NJËSISË
SË MENAXHIMIT TË
PORTOFOLIT



**SHKODRANE
ZARIQI BOGIQI**

SPECIALISTE E LARTË PËR
ANALIZË DHE ZHVILLIM
TË PRODUKTEVE



**VERË
KADRIU**

ZYRTARE E LARTË
PËR ADMINISTRATË



VILSON UKAJ

MENAXHER I NJËSISË
LIGJORE DHE
PAJTUESHMËRISË




VJOSA KELMENDI

MENAXHERE E NJËSISË
SË FINANCIVE DHE
OPERACIONEVE TË
BRENDSHME



STRUKTURA ORGANIZATIVE



BORDI I DREJTORËVE

Funksionet dhe përgjegjësitë

Bordi i Drejtorëve përbën organin më të lartë qeverisës të FKGK-së dhe luan rol kyç në drejtimin strategjik dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të FKGK-së. Ai përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët ushtrojnë mandatin e tyre në mënyrë të pavarur, profesionale dhe kolegjiale, duke vepruar në interesin më të mirë të FKGK-së. Bordi mbledhet së paku katër (4) herë në vit, ndërsa sipas nevojës edhe më shpesh, për të shqyrtuar çështje me rëndësi strategjike dhe operative. Bordi i Drejtorëve ka rol vendimmarrës dhe mbikëqyrës mbi funksionimin e përgjithshëm të FKGK-së. Në ushtrimin e mandatit të tij, ai siguron drejtimin strategjik, stabilitetin financiar dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ institucional.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË BORDIT PËRFSHIJNË:

- **Vendimmarrjen strategjike në kuadër të skemave të garancisë** – miratimin e regjistrimit dhe pjesëmarrjes së institucioneve financiare në skemat e garancisë kreditore dhe të marrëveshjeve të garancisë, si dhe përcaktimin e drejtimin strategjik për zhvillimin dhe zgjerimin e skemave të garancisë, duke përfshirë miratimin e produkteve të reja të garancisë, objektivave strategjike dhe prioritetëve për mbështetjen e qasjes në financa për bizneset;
- **Miratimin e kornizës rregullative të institucionit** – miratimin e statutit, politikave, procedurave, udhëzimeve dhe akteve të tjera të brendshme që rregullojnë organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e institucionit.

- **Mbikëqyrjen financiare dhe institucionale** – miratimin e buxhetit vjetor, pasqyrave financiare dhe politikës së investimit të kapitalit, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjeve, politikave dhe akteve të brendshme, duke siguruar menaxhim të përgjegjshëm financiar, transparencë dhe llogaridhënie institucionale, si dhe monitorimin e performancës së përgjithshme të institucionit. Përmes ushtrimit të këtyre përgjegjësi, Bordi i Drejtorëve ka kontribuar në forcimin e qëndrueshmërisë institucionale, rritjen e llogaridhënies dhe avancimin e misionit të FKGK-së në mbështetje të qasjes në financim për bizneset në Kosovë.

Gjatë vitit 2025, Bordi i Drejtorëve u mbledh gjashtë (6) herë, duke marrë vendime kyçe për funksionimin dhe zhvillimin strategjik të FKGK-së. Ndër vendimet kryesore të Bordit përfshihen: miratimi i marrëveshjeve të reja të garancisë me IRF-të për dritaret start-up, gratë në biznes dhe standard, ndryshimi i kushteve dhe kriterëve në kuadër të dritares GROW dhe marrëveshjeve të reja të garancisë me IRF-të në kuadër të kësaj dritareje, miratimi i buxhetit vjetor dhe pasqyrave financiare, miratimi i tarifave të reja të garancisë, si dhe aprovimi i politikave dhe procedurave të reja për përmirësimin e operacioneve dhe mbikëqyrjen e rrezikut, përmirësimin e proceseve të brendshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, avancimin e strukturës së pagave, forcimin e rregullave dhe procedurave të prokurimit, si dhe përshtatjen me standardet e reja në fushën mjedisore dhe sociale.

KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve themelon komitete që mbështesin punën e tij. Komitetet analizojnë çështjet brenda fushëveprimit të tyre, monitorojnë aktivitetet e FKGK-së në fushat ku kërkohen diskutime më të fokusuara, të specializuara dhe teknike. Komitetet, për punën e tyre, i raportojnë Bordit. Aktualisht, Bordi ka themeluar Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut dhe Komitetin e Auditimit si komitete të përhershme.

KOMITETI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT ndihmon Bordin e Drejtorëve në fushën e menaxhimit të rrezikut. Ky Komitet ka përgjegjësi që t'i shqyrtojë politikat e rrezikut kreditor dhe operativ, mbikëqyrë zhvillimet e portofolit të garantuar dhe të sigurojë që profili i rrezikut kreditor është në përputhje me politikat kreditore, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Ky Komitet përbëhet së paku nga tre (3) anëtarë të Bordit dhe mban takime së paku çdo tre (3) muaj.

KOMITETI I AUDITIMIT është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve për Bordin e Drejtorëve për çështjet e menaxhimit të rrezikut, të kontrollit të brendshëm, pasqyrave financiare, kërkesave të pajtueshmërisë, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe funksione të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Ky Komitet përbëhet së paku nga tre (3) anëtarë të Bordit dhe mban takime në çdo tre muaj.

Të dy komitetet e Bordit kontribuojnë në forcimin e transparencës, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së FKGK-së. Gjatë vitit 2025, komitetet janë mbledhur pesë herë, duke shqyrtuar çështje të rëndësishme në kuadër të fushëveprimit të tyre.

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE

Tabela në vijim paraqet mbledhjet Bordit të Drejtorëve të FK GK-së:

ORARI I MBLEDHJEVE TË BORDIT	NUMRI I TEMAVE TË DISKUTUARA	NUMRI I VENDIMEVE TË MARRA
26 shkurt 2025	12	9
02 prill 2025	3	3
28 prill 2025	8	4
20 qershor 2025	12	10
25 shtator 2025	20	13
29 dhjetor 2025	16	10
GJITHSEJ:	71	49

Tabela në vijim paraqet mbledhjet e Komitetit të Menaxhimi të Rrezikut (KMR):

ORARI I MBLEDHJEVE I KMR-së	NUMRI I TEMAVE TË DISKUTUARA	NUMRI I VENDIMEVE/ REKOMANDIMEVE TË MARRA
21 shkurt 2025	6	3
24 prill 2025	6	2
17 qershor 2025	5	2
22 shtator 2025	8	4
03 dhjetor 2025	7	4
GJITHSEJ:	32	15

Tabela në vijim paraqet mbledhjet e Komitetit të Auditimit (KA):

ORARI I MBLEDHJEVE I KA-së	NUMRI I TEMAVE TË DISKUTUARA	NUMRI I VENDIMEVE/ REKOMANDIMEVE TË MARRA
19 shkurt 2025	3	-
22 prill 2025	1	-
10 Qershor 2025	2	-
18 shtator 2025	1	-
27 nëntor 2025	3	-
GJITHSEJ:	10	-

PJESA IV





BASHKËPUNËTORËT E FKGGK-së

DONATORËT



QEVERIA E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

AGJENCIA AMERIKANE
PËR ZHVILLIM
NDËRKOMBËTAR
(USAID)

KFW



KfW BANKA ZHVILLIMORE

BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE
PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR (SIDA)
e përfaqësuar nga
Ambasada Suedeze



BANKA BOTËRORE



U.S. International
Development
Finance Corporation

KORPORATA FINANCIARE PËR ZHVILLIM



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të
Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregulorës (EU) Nr
1207/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e
Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve
të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014-2020).



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

FONDACIONI KOSOVAR
I MILENIUMIT (MFK) dhe
KOROPRATA E SFIDAVE TË
MIJËVJEÇARIT



BANKA EVROPIANE
E INVESTIMEVE
(EIB)

INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE PARTNERE

INSTITUCIONET BANKARE



INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE



INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE



ASOCIACIONI EVROPIAN I INSTITUCIONEVE GARANTUESE

Asociacioni Evropian i Institucioneve Garantuese (AECM), me seli në Bruksel, është organizata kryesore evropiane që përfaqëson institucionet garantuese dhe promovon rolin e garancive kreditore në lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). E themeluar në vitin 1992, AECM numëron 48 anëtarë nga 31 vende evropiane deri në fund të vitit 2025.

Anëtarët e AECM-së janë paraqitur në hartën e mëposhtme.



Që nga viti 2018, FKGK përfaqëson Kosovën në këtë rrjet prestigjioz evropian, duke kontribuar në shkëmbimin e praktikave më të mira, promovimin e instrumenteve garantuese dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe në Evropë. Gjatë vitit 2025, FKGK mori pjesë aktive në aktivitetet kryesore të AECM-së. Në ngjarjen vjetore të organizuar nga AECM, FKGK prezantoi temën "Rritja e ndikimit në zhvillim, përmes garancive", duke ndarë përvojat dhe rezultatet e institucionit në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe zgjerimin e qasjes në financa për bizneset në Kosovë.

Po ashtu, në muajin tetor, FKGK mori pjesë në takimin e OTS (Operational Training Seminar)

të organizuar nga AECM në Paris, me temën "Garancitë kreditore për përfshirjen ekonomike dhe sociale". Në kuadër të këtij takimi, FKGK prezantoi Dritaren për Gratë në Biznes, me fokus të veçantë në komponentën jofinanciare të programit, përfshirë iniciativat për ngritjen e kapaciteteve të grave sipërmarrëse në fushat e edukimit financiar, marketingut digjital dhe komunikimit. Pjesëmarrja në këto forume ndërkombëtare i mundëson FKGK-së të promovojë përvojën e Kosovës në sektorin e garancive kreditore, të mësojë nga praktikatat më të avancuara evropiane dhe të forcojë më tej rolin e saj në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të NMVM-ve.

PJESA V





TË ARRITURAT OPERACIONALE TË FKGGK-SË

TË ARRITURAT NË VITIN 2025

GARANCIONE
TË MIRATUARA

121

MILIONË EURO

NUMRI I
KREDIVE TË
APROVUARA

3,653

BIZNESE QË
KANË MARR KREDI
TË PARËN HERË

631



KREDI TË APROVUARA

242

MILIONË EURO

NUMRI I BIZNESEVE
TË GARANTUARA
NË PRONËSI
TË GRAVE

528

BIZNESE NË PRONËSI
TË GRAVE SI PJESË
E BIZNESEVE TË
GARANTUARA

17%

NUMRI I
BIZNESEVE TË
GARANTUARA

3,111

ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE KREDITORE

Viti 2025 shënoi një tjetër vit të rëndësishëm në rrugëtimin e FKKG-së drejt fuqizimit të qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë. Përmes zhvillimeve të reja institucionale dhe përmirësimit të vazhdueshëm të skemave garantuuese, FKKG-ja vazhdoi të zgjerojë ndikimin në mbështetjen e ndërmarrësive dhe të zhvillimit ekonomik.

Rritja e portofolit të garancive gjatë këtij viti ishte rezultat i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit të ngushtë dhe besimit të institucioneve financiare partnere në mekanizmat e FKKG-së. Përmes skemave garantuuese, të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të segmenteve të ndryshme të tregut, FKKG-ja arriti të ofrojë zgjidhje financimi më të përshtatura dhe më të qasshme për NMVM-të.

Ndër zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2025 ishte avancimi i financimit të gjelbër përmes përmirësimit të kushteve të Dritares GROW (Dritarja për Rimëkëmbje dhe Mundësi të Gjelbra), si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet FKKG-së dhe IRF-ve për të nxitur investimet në efikasitetin e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme.

Në të njëjtën kohë, FKKG-ja ndërmori hapa për thellimin e financimit gjithëpërfshirës, përmes aplikimit të tarifave preferenciale të garancisë për Dritaren Start-up dhe Dritaren për Gratë në Biznes. Këto masa u shoqëruan me zotime të përbashkëta me bankat partnere për përmirësimin e kushteve të kreditimit dhe rritjen e mbështetjes për këto segmente. Paralelisht, FKKG-ja zgjeroi bashkëpunimin me institucionet mikrofinanciare, duke mundësuar përdorimin e dritareve të tjera të garancisë përtej Dritares Agro. Ky hap synon të rrisë më tej qasjen në financa për ndërmarrjet mikro dhe bizneset në zonat më pak të shërbyera nga sistemi financiar.

Gjatë vitit 2025, kreditimi i ndërmjetësuar për NMVM-të arriti në 242.5 milionë euro, i shpërndarë në 3,653 kredi, duke lehtësuar qasjen në financa për 3,111 ndërmarrje. Në fund të vitit, shuma totale kumulative e kredive të miratuara arriti në 1.04 miliardë euro, duke mbështetur gjithsej 12,767 NMVM, ndërsa shuma kumulative e garancive arriti në 535.3 milionë euro.

Në fund të vitit 2025, vlera totale e mbetur e portofolit të kredive ishte 358.7 milionë euro, ndërsa portofoli i garantuar arriti në 179.5 milionë euro, i shpërndarë në 8,208 kredi aktive.

Sa i përket shpërndarjes sektoriale, sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë mbeti më dominuesi në portofolin aktiv të kredive të garantuara, me 39.61%, i ndjekur nga shërbimet me 24.85%, prodhimi me 20.85%, bujqësia me 8.15% dhe ndërtimtaria me 6.54%¹. Dominimi i sektorit të tregtisë vazhdon të dëshmojë rolin e tij të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik, ndërkohë që pjesëmarrja e sektorëve të shërbimeve, prodhimit dhe bujqësisë tregon kontributin e skemës së garancisë në mbështetjen e investimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve në sektorët kyç të ekonomisë.

Analiza e portofolit sipas qëllimit të financimit gjatë vitit 2025 tregon se kreditë e garantuara janë përdorur kryesisht për kapital qarkullues dhe kredi afatshkurtra, të cilat përfaqësojnë 54.44% të portofolit, ndërsa kreditë investive përbëjnë 45.50%. Pjesa e financimit për kapital qarkullues pasqyron nevojën e bizneseve për të mbështetur aktivitetet e tyre të përditshme, menaxhimin e likuiditetit dhe financimin e ciklit operativ. Nga ana tjetër, financimi për investime ka kontribuar në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e pajisjeve, zhvillimin e infrastrukturës së biznesit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve. Shpërndarja ndërmjet financimit afatshkurtër dhe atij investiv demonstroi rolin e FKKG-së si në adresimin e nevojave të menjëhershme të bizneseve për likuiditet, ashtu edhe në mbështetjen e investimeve që krijojnë potencial për rritje dhe zhvillim afatgjatë të ekonomisë. Nga perspektiva e madhësisë së bizneseve, portofoli i garantuar vazhdoi të dominohej nga ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Segmenti i ndërmarrjeve me deri në 50 punëtorë përfaqësoonte 98% të portofolit sipas numrit të kredive, duke reflektuar qartë fokusin e FKKG-së në mbështetjen e bizneseve që përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë së vendit.

Progresi i arritur gjatë vitit 2025 në zhvillimin e portofolit të garancive, si dhe iniciativat e ndërmarrja gjatë këtij viti, dëshmojnë përkushtimin e FKKG-së ndaj përmirësimit të vazhdueshëm dhe forcimit të rolit të saj në krijimin e një ekosistemi financiar më gjithëpërfshirës, më të qëndrueshëm dhe më të orientuar drejt zhvillimit afatgjatë të ekonomisë së Kosovës.

1 Aktiviteti ekonomik NACE 4120 – Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore – nuk konsiderohet i kualifikueshëm. Përfshihen investimet në energjinë e ripërtëritshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara për kualifikueshmëri.

KOMPONENTA FINANCIARE DRITARET GARANTUESE TË FKGGK-së

Komponenta financiare përbën shtyllën kryesore të veprimtarisë së FKGGK-së dhe realizohet përmes skemave garantuese të ofruara për institucionet financiare partnere, me të cilat ndajmë rrezikun kreditor për kreditë e dhëna për NMVM-të. Përmes këtij mekanizmi, bankat dhe institucionet tjera financiare inkurajohen të zgjerojnë kreditimin për bizneset, duke adresuar një nga sfidat kryesore të sektorit privat – qasjen në financa. FKGGK-ja operon përmes shtatë dritareve garantuese, të cilat janë të dizajnuara për të adresuar nevoja specifike të tregut dhe për të mbështetur segmente të ndryshme të ekonomisë.

DRITARJA STANDARDE

E themeluar në vitin 2016, njëkohësisht me themelimin e institucionit, Dritarja Standarde është dritare gjithëpërfshirëse dhe e përgjithshme, duke mbështetur NMVM-të në të gjithë sektorët e lejuar të ekonomisë, duke ofruar garanci për kredi investuese dhe për kapital qarkullues.

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë: **3,000 euro**
- Shuma maksimale e kredisë: **3,000,000 euro**
- Shuma maksimale e garancisë: **500,000 euro**
- Afati maksimal i kredisë: **deri 120 muaj**
- Norma e garancisë në nivel individual: **deri në 50%**

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative mbi 14,669 kredi në vlerë prej 745.2 milionë euro.

2025

14,669
KREDI

745.2
milionë
euro



DRITARJA
STANDARDE



DRITARJA AGRO

E themeluar në vitin 2018, kjo dritare synon të adresojë qasjen në financa për fermerët dhe ndërmarrjet në sektorin e agrikulturës. Ajo mbulon të gjithë zinxhirin e vlerës së ushqimit, nga prodhimi primar deri te përpunimi. Një veçori e kësaj dritareje është se ofron garanci jo vetëm për bizneset e regjistruara në ARBK, por edhe për fermerët që posedojnë Certifikatën e Fermerit dhe Numrin Identifikues të Fermës (NIF).

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë: **3,000 euro**
- Shuma maksimale e kredisë: **3,000,000 euro**
- Shuma maksimale e garancisë: **500,000 euro**
- Afati maksimal i kredisë: **deri 120 muaj**
- Norma e garancisë në nivel individual: **deri në 60%**

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative 2,800 kredi në vlerë prej 96.1 milionë euro.

2025

2,800
KREDI

96.1
milionë
euro



DRITARJA GROW

E themeluar në qershor 2022, kjo dritare mbështet investimet në pajisje dhe teknologji që mundësojnë të paktën 15% kursim në energjinë primare dhe/ose reduktim të emetimeve të CO₂, si dhe prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme për vetëkonsum. Në nivel të portofolit, investimet e mbështetura synojnë të arrijnë së paku 20% kursim në energjinë primare, pa rritje të emetimeve të CO₂, duke kontribuar në tranzicionin e bizneseve drejt praktikave më të qëndrueshme dhe zhvillimin e një ekonomie më të gjelbër.

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë:
- Shuma maksimale e kredisë:
- Shuma maksimale e garancisë:
- Afati maksimal i kredisë:
- Norma e garancisë në nivel individual:
- Norma e garancisë në nivel portofoli:

3,000 euro

3,000,000 euro

1,000,000 euro

deri 120 muaj

deri në 70%

deri në 30%

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative 50 kredi në vlerë prej 9.6 milionë euro.

2025

50
KREDI

9.6
milionë
euro

GROW

Green
Recovery and
Opportunity
Window



DRITARJA E EKSPORTIT

E themeluar në vitin 2022, kjo dritare synon të mbështesë ndërmarrjet që eksportojnë në mënyrë të rregullt ose planifikojnë të fillojnë aktivitetet e eksportit, duke lehtësuar qasjen në financim për investime dhe kapital qarkullues që lidhen me aktivitetet e eksportit.

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë: **3,000 euro**
- Shuma maksimale e kredisë: **3,000,000 euro**
- Shuma maksimale e garancisë: **1,000,000 euro**
- Afati maksimal i kredisë: **deri 120 muaj**
- Norma e garancisë në nivel individual: **deri në 50%**

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative 327 kredi në vlerë prej 46.9 milionë euro.

Kjo dritare vazhdon të jetë një nga instrumentet më aktive në portofolin e FKGK-së.



DRITARJA START-UP

Kjo dritare synon të mbështesë ndërmarrjet e reja që kanë deri në 12 muaj përvojë në biznes, duke stimuluar iniciativat ndërmarrëse dhe zhvillimin e bizneseve në fazat e hershme. FKGK-ja ka filluar të operojë me këtë dritare në vitin 2023.

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë: **3,000 euro**
- Shuma maksimale e kredisë: **100,000 euro**
- Shuma maksimale e garancisë: **80,000 euro**
- Afati maksimal i kredisë: **deri 84 muaj**
- Norma e garancisë në nivel individual: **deri në 80%**
- Norma e garancisë në nivel portofoli: **deri në 30%**

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative **311 kredi** në vlerë prej **8.9 milionë euro**.



DRITARJA
START-UP

DRITARJA GRATË NË BIZNES

E themeluar në vitin 2023, kjo dritare synon të mbështesë bizneset në pronësi ose bashkëpronësi të së paku një gruaje, pavarësisht pjesëmarrjes në kapital, ose bizneset të udhëhequra nga të paktën një grua në pozitë ekzekutive, duke promovuar përfshirjen financiare dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë: **3,000 euro**
- Shuma maksimale e kredisë: **250,000 euro**
- Shuma maksimale e garancisë: **175,000 euro**
- Afati maksimal i kredisë: **deri 120 muaj**
- Norma e garancisë në nivel individual: **deri në 70%**
- Norma e garancisë në nivel portofoli: **deri në 20%**

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative 624 kredi në vlerë prej 24.4 milionë euro.

2025

624
KREDI

24.4
milionë
euro



DRITARJA PËR INVESTIME TË DIASPORËS

E themeluar në korrik të vitit 2024, kjo dritare ka për qëllim lehtësimin e qasjes në financim për investorët nga diaspora që investojnë në Kosovë. Ajo u dedikohet personave që kanë lindur në Kosovë ose që kanë apo kanë pasur shtetësinë e Kosovës, por kanë emigruar dhe kanë jetuar për më shumë se tri vite jashtë Kosovës, si dhe pasardhësve deri në gjeneratën e dytë të prindërve me origjinë nga Kosova. Në kuadër të kësaj dritareje mbështeten NMVM-të në pronësi private nga diaspora e Kosovës, të sapo themeluara ose ekzistuese me deri në tridhjetë e gjashtë muaj nga data e regjistrimit.

Kushtet e përgjithshme

- Shuma minimale e kredisë: **3,000 euro**
- Shuma maksimale e kredisë: **3,000,000 euro**
- Shuma maksimale e garancisë: **2,000,000 euro**
- Afati maksimal i kredisë: **deri 84 muaj**
- Norma e garancisë në nivel individual: **deri në 80%**
- Norma e garancisë në nivel portofoli: **deri në 15%**

Përmes kësaj dritareje janë garantuar në vlerë kumulative 29 kredi në vlerë prej 5.8 milionë euro.



Përmes këtyre dritareve të specializuara dhe instrumenteve të reja, FKGK-ja mbështet investime që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke inkurajuar praktika biznesi që janë në përputhje me parimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes dhe me prioritetet zhvillimore të vendit.

Përveç shtatë dritareve aktive garantuese, FKGK-ja vazhdon të menaxhojë portofolin e mbetur të dritareve të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, të krijuara për të mbështetur bizneset e prekura nga pandemia COVID-19. Edhe pse këto dritare nuk pranojnë më raste të reja që nga përfundimi i periudhës së përfshirjes më 31 dhjetor 2021, ekspozimet ekzistuese mbeten aktive dhe monitorohen deri në përfundimin e obligimeve garantuese.

Tabela në vijim paraqet ekspozimet aktive PRE

Dritarja	Viti i themelimit	Statusi	Portofoli i mbetur (€)	Numri i kredive aktive
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike	2021	E mbyllur për raste të reja	5.5 milionë	320

KOMPONENTA JOFINANCIARE

Përveç mbështetjes financiare, FK GK-ja investon në mënyrë aktive edhe në rritjen e kapaciteteve të institucioneve financiare dhe të vetë bizneseve përfituese, duke ditur se zhvillimi i qëndrueshëm kërkon jo vetëm financim, por edhe njohuri dhe aftësi më të avancuara.

TRAJNIMI I STAFIT TË IRF-ve

Një pjesë e rëndësishme e kësaj qasjeje është mbështetja për institucionet financiare partnere dhe stafin e tyre, përmes trajnimeve dhe mjeteve të tjera profesionale që ndihmojnë në kuptimin dhe zbatimin më efektiv të dritareve garantuese.

Gjatë vitit 2025, në përputhje me objektivat e institucionit për të siguruar shërbime me standard të lartë dhe shpërndarje më të barabartë të garancive në të gjitha rajonet e Kosovës, FK GK-ja realizoi një analizë të shfrytëzimit të dritareve garantuese nga institucionet financiare në rajone të ndryshme të vendit. Bazuar në këtë analizë, u organizuan trajnime të synuara për stafin e institucioneve financiare aty ku nevojat ishin më të mëdha, me qëllim rritjen e vetëdijes për skemat garantuese dhe për vlerën e tyre të shtuar për institucionet financiare, NMVM-të dhe ekonominë në përgjithësi.

Si rezultat, gjatë vitit 2025 u organizuan 20 sesione informuese në shtatë qendrat kryesore të Kosovës, ku morën pjesë 403 përfaqësues të stafit të institucioneve financiare.

FUQIZIMI I NMVM-ve PËRMES NJOHURIVE DHE RRJETËZIMIT

Paralelisht me këto aktivitete, FK GK-ja vazhdoi të mbështesë edhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, përmes programeve të asistencës teknike dhe trajnimeve tematike. Qëllimi është të forcohen kapacitetet e bizneseve në fusha si menaxhimi financiar, lidërshipi, depërtimi në treg dhe komunikimi.

Një fokus i veçantë i këtyre programeve është vendosur te gratë në biznes, duke ditur se përveç qasjes në financa, ato kanë nevojë edhe për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive ndërmarrëse dhe të rrjeteve profesionale.

Në vitin 2025, si vazhdimësi e iniciativave të viteve 2023 dhe 2024 me temën "Avancimi i Njohurive Financiare", FK GK-ja implementoi një program të asistencës teknike me mbështetjen e Sida-s, i cili kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve të segmenteve të caktuara të biznesit, veçanërisht të grave ndërmarrëse.

Programi u fokusua në:

- Ndërtim të kapaciteteve profesionale,
- rrjetëzim,
- mentorim.

Deri më tani janë realizuar sesione trajnimi me tema si Marketingu Digjital dhe Komunikimi, për të ndihmuar bizneset pjesëmarrëse të përmirësojnë pranimë e tyre në treg dhe strategjitë e komunikimit me klientët.

Gjatë raundit të parë të programit (tetor – nëntor 2025) u realizuan:

- 17 sesione trajnimi,
- me 204 pjesëmarrës,
- në 7 qytete të Kosovës.

Ky program do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2026, duke zgjeruar më tej mbështetjen për ndërmarrjet në rajone të ndryshme të Kosovës dhe duke kontribuar në zhvillimin e një ekosistemi më të fortë dhe më të qëndrueshëm të ndërmarrësisë.

NJË QASJE PËR NDIKIM AFATGJATË

Duke kombinuar instrumentet financiare me mbështetjen jofinanciare, FK GK-ja synon të ketë ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo qasje jo vetëm që rrit qasjen e NMVM-ve në financa, por gjithashtu fuqizon bizneset me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të rritur konkurrueshmërinë, për të adoptuar praktika të përgjegjshme biznesi dhe për të kontribuar në një ekonomi më gjithëpërfshirëse dhe më të qëndrueshme.

SHTUESHMËRIA

Shtueshmëria përfaqëson parimin bazë mbi të cilin vlerësohet ndikimi i instrumenteve të garancive kreditore. Ajo nënkupton ndryshimin pozitiv që gjenerohet si rezultat i ndërhyrjes, krahasuar me situatën që do të ekzistonte në mungesë të saj. Në rastin e FK GK-së, shtueshmëria manifestohet përmes përmirësimit të qasjes në financa dhe kushteve të kreditimit për NMVM-të, veçanërisht për ato segmente që përballen me kufizime më të mëdha financiare. Duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare partnere, FK GK-ja nxit rritjen e kreditimit, ul barrierat që lidhen me kolateralin, mundëson maturitete më të gjata dhe krijon kushte më të favorshme financimi. Si rezultat, bizneset kanë mundësi më të mëdha për të investuar, zgjeruar aktivitetin e tyre dhe krijuar vende të reja pune, duke gjeneruar ndikim të qëndrueshëm ekonomik dhe zhvillim më gjithëpërfshirës. Krahasimi ndërmjet kreditimit të garantuar dhe atij të paguar brenda këtij segmenti, bazuar në të dhënat e siguruar nga BQK-ja, demonstrojnë se si FK GK-ja i adreson barrierat kryesore strukturore, si kërkesat e larta për kolateral, maturitetet më të shkurtra të kredive dhe qasja e kufizuar në financim. Fokus i veçantë i këtij vlerësimi janë kreditë deri në €100,000, të cilat përbëjnë segmentin kryesor të financimit të NMVM-ve dhe mbi 65% të portofolit të përgjithshëm të garantuar nga FK GK-ja.

Gjetjet nga kjo analizë e të dhënave konfirmojnë se FK GK-ja luan një rol kritik në përmirësimin e kushteve të kreditimit për NMVM-të, veçanërisht në segmentet ku kreditimi mbetet i kufizuar. Ndërhyrja e FK GK-së jo vetëm që zgjeron qasjen në financa, por gjithashtu përmirëson cilësinë dhe qëndrueshmërinë e kreditimit në të gjithë sektorin.

PJESËMARRJA DHE SHTRIRJA NË TREG

Gjatë vitit 2025, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore arriti një pjesëmarrje prej 22.78% në sektorin bankar, duke konfirmuar rolin e rëndësishëm të garancive kreditore në financimin e NMVM-ve.

Analiza sipas madhësisë së kredisë tregon se rëndësia e mbështetjes së FK GK-së rritet bashkë me nevojat për financim. Pjesëmarrja është më e lartë në segmentet €25,000–€50,000 (25.96%) dhe €50,000–€100,000 (24.32%), duke pasqyruar kështu ndikimin e fondit në lehtësimin e qasjes në financim për investime me vlerë më të lartë dhe për projekte të zgjerimit të biznesit.

Këto rezultate tregojnë se FK GK-ja luan rol kyç në ndarjen e rrezikut dhe në zgjerimin e kreditimit për bizneset në segmentet ku financimi tradicional mbetet më i kufizuar. Ky ndikim reflektohet veçanërisht në përfshirjen financiare të ndërmarrjeve të reja në sistemin bankar, ku gjatë vitit 2025, 95% e NMVM-ve që kanë marrë kredi për herë të parë janë mbështetur përmes kredive të garantuara nga FK GK.


Tabela në vijim paraqet pjesëmarrjen e FK GK-së në sektorin bankar (%).

KATEGORIA E KREDISË	PJESËMARRJA E FK GK NË SEKTORIN BANKAR (%)
Deri në €10,000	8.15%
€10,000 – €25,000	16.76%
€25,000 – €50,000	25.96%
€50,000 – €100,000	24.32%
GJITHSEJ:	22.78%

KËRKESAT PËR KOLATERAL

Ulja e kërkesave për kolateral mbetet një nga kontributet më transformuese të FK GK-së në tregun kreditor të Kosovës. Sipas të dhënave, NMVM-të pa mbështetje garantuese vazhdojnë të përballen me nivele të larta të kolateralizimit, të cilat shpesh kufizojnë qasjen në financim formal. FK GK-ja adreson drejtpërdrejt këtë kufizim duke ulur ndjeshëm kërkesat për kolateral në segmentet kryesore të kredisë. Ndikimi është veçanërisht i dukshëm tek kreditë e vogla dhe të mesme, ku përqendrohet pjesa më e madhe e aktivitetit të NMVM-ve.

Grafi në vijim paraqet diferencën në mbulimin me kolateral FK GK ndaj sektorit.



Këto ulje tregojnë se kreditë e mbështetura nga FK GK kërkojnë afërsisht dy të tretat më pak kolateral krahasuar me kreditë jo të garantuara.

Duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare partnere, FK GK inkurajon zgjerimin e kreditimit drejt ndërmarrjeve me potencial të lartë zhvillimi, të cilat mund të mos disponojnë kolateral të mjaftueshëm pavarësisht aftësisë së tyre për të përmbushur obligimet kreditore.


Ulja e vazhdueshme e kërkesave për kolateral në të gjitha kategoritë e kredive tregon se ndikimi i FK GK-së është sistemik dhe jo i kufizuar vetëm në portofolin e garantuar, duke kontribuar në ndryshimin e praktikave të kreditimit në sektorin financiar.

Ky ndikim në uljen e mbulimit me kolateral konfirmohet edhe nga të dhënat e FK GK-së, sipas të cilave 30% e kredive të garantuara mbi 100 mijë euro janë lëshuar pa kolateral.

ZGJATJA E MATURITETIT


Garancionet e FK GK-së përmirësojnë ndjeshëm maturitetin e kredive, duke u mundësuar bizneseve të harmonizojnë pagesat me ciklet afatgjata të investimeve dhe jo vetëm me kufizimet afatshkurtra të likuiditetit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për NMVM-të që realizojnë investime kapitale me periudha më të gjata kthimi. Në nivel të përgjithshëm, kreditë e mbështetura nga FK GK-ja tregojnë avantazh të qartë sa i përket maturitetit krahasuar me sektorin më të gjërë kreditor.

Grafi në vijim paraqet diferencën në mbulimin me kolateral midis kredive të garantuara dhe të pagarantuara.



Një ndarje më e detajuar sipas madhësisë së kredisë tregon se avantazhi në maturitet rritet bashkë me vlerën e kredisë.

Grafi në vijim paraqet mesataren e maturitetit të kredive të garantuara dhe atyre të pagarantuara



Nga perspektiva e kredimarrësit, maturitetet më të gjata nënkuptojnë presion më të ulët mujor të pagesave, amortizim më të ngadaltë të kredisë dhe menaxhim më të mirë të rrjedhës së parasë.


Kjo u mundëson bizneseve të rrisin kapacitetin investues, të ndërmarrin investime më të mëdha dhe më produktive, si dhe të harmonizojnë më mirë afatet e pagesave me gjenerimin e të ardhurave.

KRAHASIMI I VËLLIMIT TË KREDITIMIT

Të dhënat konfirmojnë gjithashtu se skema garantuese e FK GK-së shërben si një nxitës i rëndësishëm për rritjen e vëllimit të kredive në krahasim me sektorin financiar të Kosovës. Duke zbutur rrezikun kreditor për institucionet financiare partnere, skema garantuese rrit besimin e tyre dhe mundëson ofrimin e kredive më të mëdha për NMVM-të.

Krahasimi me sektorin nxjerr në pah një diferencë të konsiderueshme sa i përket madhësisë mesatare të kredive:

Grafi në vijim paraqet mesataren e maturitetit për kreditë e garantuara dhe të pagarantuara të ndara sipas madhësisë së kredisë




Kjo diferencë në vlerën mesatare të kredive të garantuara në krahasim me kreditë e pagarantuara demonstroi se kreditë e mbështetura nga FK GK-ja u mundësojnë bizneseve të kenë qasje në shuma më të mëdha të kapitali sesa do të ishte e mundur në kushtet standarde të tregut.

PJESËMARRJA E VËLLIMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FKGK NË BRUTO PRODHIMIN VENDOR (BPV)

Figura më poshtë paraqet intensitetin e ndërhyrjes së FKGK-së në ekonomi, përmes raportit ndërmjet garancive aktive dhe BPV-së¹. Krahasoni ndërkombëtar tregon se Kosova renditet ndër vendet me nivelin më të lartë të përdorimit të skemave garantuese në Evropë, me 1.3% të BPV-së të mbuluar nga garancitë aktive të FKGK-së.

Krahasuar me shumicën e vendeve evropiane, ku ky tregues mbetet nën 1%, niveli relativisht i lartë në Kosovë tregon rëndësinë që ka fondi garantues në rritjen ekonomike.

Harta e intensitetit – raporti i vëllimit të garancive aktive ndaj BPV-së




1 Të dhënat janë paraqitur për vitin 2024 nga AECM Statistical Yearbook 2024.

PJESËMARRJA E BIZNESEVE TË GARANTUARA NË RAPORT ME TË GJITHA BIZNESET AKTIVE NË EKONOMINË REALE

Grafiku më poshtë paraqet pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të garantuara në raport me totalin e ndërmarrjeve në treg. Të dhënat tregojnë se FKGK-ja ka një nivel relativisht të lartë të pjesëmarrjes në treg krahasuar me shumë vende evropiane, me rreth 20.4% të NMVM-ve të mbështetura nga garancionet kreditore. Krahasoni me vendet e Evropës tregon se skemat garantuese në Kosovë luajnë rol më të rëndësishëm në financimin e sektorit privat sesa në shumicën e vendeve të rajonit dhe Evropës. Ky nivel i pjesëmarrjes reflekton rëndësinë e mekanizmave të ndarjes së rrezikut në zgjerimin e qasjes në financa dhe në mbështetjen e zhvillimit të NMVM-ve.

Harta e Intensitetit – Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të garantuara në totalin e NMVM-ve



2 Të dhënat janë paraqitur për vitin 2024 nga AECM Statistical Yearbook 2024.

ANGAZHIMET ME PALËT E INTERESIT GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, FK GK-ja vazhdoi të thellojë rolin e tij si institucion kyç për mbështetjen e financimit të sektorit privat dhe zhvillimit të NMVM-ve në Kosovë. Përmes zgjerimit të bashkëpunimeve strategjike me partnerë ndërkombëtarë, FK GK-ja kontribuoi në rritjen e qasjes në financa, përfshirjen financiare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të sektorit financiar.

Një arritje me rëndësi të veçantë strategjike gjatë vitit ishte operacionalizimi i Programit të Garancisë së Ballkanit Perëndimor i financuar nga Bashkimi Evropian dhe KfW, me vlerë prej 22 milionë eurosh. Ky instrument pritet t'i mundësojë FK GK-së të gjenerojë së paku 44 milionë euro garanci dhe të mbështesë kreditim në vlerë prej së paku 88 milionë eurosh për NVM-të në Kosovë.

Ky ri-garancion synon të përmirësojë qasjen në financa për segmentet prioritare të ekonomisë, me fokus të veçantë në:

- Ndërmarrjet në zonat rurale,
- Ndërmarrjet prodhuese, dhe
- Ndërmarrjet start-up.

Përveç zgjerimit të kapacitetit garantues të FK GK-së, marrëveshja kontribuon në uljen e tarifave të garancisë, përmirësimin e kushteve të financimit dhe mobilizimin e investimeve private, duke mbështetur rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat.

Një ndër zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit ishte vazhdimi i zbatimit të marrëveshjes me Sida-n, e cila përveç mbështetjes përmes garancive kreditore për gratë ndërmarrëse, ndërmarrjet e orientuara drejt eksportit dhe investimet e gjelbra, kishte në fokus të veçantë edhe komponentin jo-financiar. Ky komponent synon të adresojë barrierat që nuk lidhen drejtpërdrejt me qasjen në financa, por me kapacitetet e ndërmarrjeve për të përfituar dhe përdorur në mënyrë efektive financimin.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, FK GK-ja vazhdoi bashkëpunimin me EIB, DFC dhe SIDA duke kontribuar në rritjen e vëllimit të kredive të mbështetura nga këto institucione. Këto bashkëpunime mbështetën kreditimin e bizneseve me potencial zhvillimi dhe realizimin e investimeve produktive në eksport, prodhim, bujqësi, ndërmarrje start-up dhe investime të gjelbra.

Tabela në vijim paraqet Vlerën e aprovuar të kredive dhe garancioneve të mbështetura nga fondi EIB si dhe nga rigarantuesit SIDA dhe DFC

Fondi	Vlera e aprovuar e kredive	Vlera e aprovuar e garancioneve
EIB	72,910,520	35,242,555
Rigarantues		
DFC	3,438,459	1,706,230
SIDA	29,091,100	15,097,790

Në tërësi, viti 2025 u karakterizua nga zgjerimi i partneriteteve strategjike, avancimi i instrumenteve garantuese dhe forcimi i rolit të FK GK si një mekanizëm kyç për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e qasjes në financa në Kosovë.

AVANCIMI I FINANCIMIT TË GJELBËR PËRMES DRITARES GROW

Viti 2025 shënoi një hap të rëndësishëm në avancimin e agjendës së financimit të gjelbër në Kosovë. Me qëllim të përsheptimit të investimeve në efikasitet të energjisë dhe energji të ripërtëritshme, FK GK ndërmori një rishikim të rëndësishëm të kriterëve të kualifikimit për Dritaren GROW.

Në këtë drejtim, FK GK-ja avancoi mekanizmin e ndarjes së rrezikut dhe kriteret e kualifikimit për këtë dritare, duke e bërë financimin e projekteve të gjelbra më tërheqës dhe më të qasshëm për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Ndryshimet kryesore përfshijnë:

- rritjen e normës së garancisë nga 50% në 70%, duke rritur ndjeshëm marrjen përsipër të rrezikut nga ana e FK GK-së;
- zgjatjen e maturitetit të kredive nga 84 në 120 muaj;
- rritjen e shumës maksimale të garancisë nga 500,000 EUR në 1 milion EUR;
- rritjen e ekspozimit maksimal të kredisë nga 5 milionë EUR në 7 milionë EUR;
- uljen e mëtejshme të tarifave të garancisë.

Këto ndryshime synojnë të reduktojnë barrierat financiare për investimet e gjelbra dhe të rrisin gatishmërinë e institucioneve financiare për financimin e projekteve që përmirësojnë efikasitetin e energjisë, ulin kostot operative dhe kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit. Paralelisht me përmirësimet e kushteve financiare, FKGG-ja dhe institucionet financiare partnere kanë shprehur zotimin për t'i promovuar në mënyrë aktive këto mundësi financimi, në mënyrë që ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të informohen më mirë për vlerën e shtuar të investimeve të gjelbra. Në këtë drejtim, institucionet financiare do të angazhohen në promovimin e produkteve dhe linjave të dedikuara për financimin e investimeve të qëndrueshme, si dhe në komunikimin sistematik të përfitimeve që këto investime sjellin për bizneset dhe mjedisin.

Për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të nxitur kërkesën për financim të gjelbër, FKGG-ja, në bashkëpunim me bankat partnere, do të organizojë forume, punëtori dhe sesione informuese për NMVM-të, me fokus në investimet e qëndrueshme dhe mundësitë që ofron Dritarja GROW. Paralelisht, FKGG-ja do të vazhdojë të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të stafit të institucioneve financiare partnere përmes trajnimeve dhe ritajnimeve, me qëllim forcimin e njohurive mbi financimin e gjelbër, identifikimin e projekteve të pranueshme dhe integrimin më efektiv të praktikave të qëndrueshme në proceset e kreditimit. Përmes këtyre hapave, FKGG-ja synon të mbështesë tranzicionin drejt një ekonomie më të gjelbër, më konkurruese duke lehtësuar realizimin e investimeve që gjenerojnë vlerë ekonomike afatgjatë dhe ndikim pozitiv në mjedis dhe shoqëri.

LEHTËSIMI I QASJES NË FINANCIM PËR GRATË NË BIZNES DHE STARTUP-ËT

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2025 ishte intensifikimi i përpjekjeve për të avancuar përfshirjen në jetën ekonomike, me fokus të veçantë te gratë në biznes dhe ndërmarrjet start-up. FKGG-ja i konsideron këto segmente me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit, pasi ato luajnë një rol kyç në nxitjen të ndërmarrjes dhe inovacionit, krijimin e vendeve të reja të punës dhe zgjerimin e bazës ekonomike. Megjithatë, pavarësisht potencialit të tyre, këto kategori shpesh përballen me pengesa më të mëdha në qasjen në financim krahasuar me bizneset e konsoliduara, për shkak të mungesës së historikut financiar, kolateralit të mjaftueshëm, përvojës së kufizuar në biznes dhe qasjes më të kufizuar në rrjetet financiare dhe profesionale. Duke i njohur këto sfida dhe potencialin e këtyre segmenteve tyre për të kontribuar në një zhvillim ekonomik më dinamik dhe gjithëpërfshirës, FKGG-ja ka nisur një iniciativë

të re bashkëpunimi me institucionet financiare partnere. Kjo nismë reflekton vullnetin dhe zotimin e përbashkët për të mbështetur dhe avancuar iniciativë që synojnë përmirësimin e qasjes në financa dhe eliminimin e barrierave për grupet e nënpërfaqësuar, veçanërisht për start-up-et dhe bizneset e udhëhequra nga gratë. Në këtë drejtim, FKGG-ja dhe bankat partnere janë të përkushtuara të bashkëpunojnë ngushtë për të përmirësuar praktikën e financimit dhe për të ndërmarrë veprime konkrete që kontribuojnë në këtë agjendë.

Në kuadër të kësaj nisme, FKGG-ja dhe institucionet financiare partnere janë pajtuar të ndërmarrin hapa të koordinuar për lehtësimin e qasjes në financa, përmirësimin e kushteve të dhënies së kredive dhe rritjen e financimit të përballueshëm për këto segmente. Në mbështetje të këtij qëllimi, Bordi i Drejtorëve të FKGG-së ka miratuar tarifa preferenciale të garancisë për Gratë në Biznes dhe ndërmarrjet Start-up, me kusht që bankat partnere ta reflektojnë këtë mbështetje përmes kushteve më të favorshme të kreditimit për këto segmente.

Në këtë kontekst, bankat partnere inkurajohen të ndërmarrin hapa konkretë për:

- përmirësimin e kriterëve të kualifikimit për këto segmente;
- reduktimin e kërkesave për kolateral;
- ofrimin e kredive me maturitete më të gjata;
- rritjen e shumës maksimale të kredive;
- përfshirjen më të gjerë të bizneseve të sapo themeluara.

Njëkohësisht, bankat pritët të intensifikojnë promovimin e këtyre produkteve përmes kanaleve të tyre digjitale dhe komunikimit me klientët, me qëllim rritjen e ndërgjegjësitimit dhe shfrytëzimit të mundësive që ofrojnë Dritarja Start-up dhe Dritarja Gratë në Biznes. Kjo iniciativë është nisur në tremujorin e fundit të vitit 2025, ndërsa implementimi i plotë i saj pritët të zhvillohet gjatë vitit 2026, në bashkëpunim të ngushtë me bankat partnere.

Përmes kësaj qasjeje, FKGG-ja synon të lehtësojë qasjen në financa për ndërmarrësit e rinj dhe gratë ndërmarrëse, duke kontribuar në zhvillimin e një ekonomie më inovative dhe gjithëpërfshirëse. Kjo qasje përputhet me dimensionin social të parimeve ESG (Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse), të cilat promovojnë praktika të përgjegjshme dhe përfshirëse ndaj grupeve që përballen me barrierë më të mëdha në financim. Në këtë aspekt, përmes skemave garantuese, FKGG kontribuon në krijimin e mundësive më të barabarta për ndërmarrësi, rritjen e pjesëmarrjes ekonomike dhe një zhvillim më të qëndrueshëm.

MENAXHIMI I RREZIKUT

ROLI DHE RËNDËSIA E MENAXHIMIT TË RREZIKUT NË FKGK

Menaxhimi i rrezikut paraqet një nga shtyllat kryesore të funksionimit të FKGK-së. Si institucion që ndërmjetëson marrëdhënien ndërmjet institucioneve financiare dhe NMVM-ve, FKGK-ja është e ekspozuar ndaj një game të gjerë rreziqesh që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e saj financiare, reputacionin institucional dhe aftësinë e saj për të përmbushur misionin e saj për përmirësimin e qasjes në financim për bizneset në Kosovë.

FKGK-ja është e përkushtuar të ketë një qasje proaktive dhe të strukturuar të menaxhimit të rrezikut, në përputhje me politikat dhe procedurat e saj të brendshme. Kjo qasje mundëson identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve, duke siguruar që niveli i ekspozimit ndaj rrezikut të mbetet në përputhje me objektivat strategjike dhe aktivitetet e institucionit.

Menaxhimi i rrezikut është i integruar në të gjitha nivelet organizative të FKGK-së, duke promovuar një kulturë të ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë ndaj rrezikut në proceset e vendimmarrjes.

RREZIQET KRYESORE DHE KORNIZA E MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Për shkak të natyrës së aktivitetit garantues, skemat e garancive kreditore ekspozohen ndaj një sërë rreziqesh që mund të ndikojnë në performancën e tyre financiare dhe aftësinë e tyre për të përmbushur objektivat zhvillimore. Ndër rreziqet më të zakonshme që karakterizojnë skemat garantuese përfshihen rreziku kreditor, rreziku i përqendrimit, rreziku operacional, rreziku i likuiditetit, rreziku reputacional, si dhe rreziku moral (moral hazard), i cili mund të shfaqet në rastet kur institucionet financiare ose përfituesit e garancive ndërmarrin nivele më të larta rreziku, duke u mbështetur në mbulimin e ofruar nga garancia.

Si institucion garantues, FKGK-ja është e ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve dhe i menaxhon ato nëpërmjet një kornize të integruar të menaxhimit të rrezikut, e cila synon ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, si dhe mbështetjen e realizimit të mandatit të tij. Korniza e menaxhimit të rrezikut mbështetet në parimet e identifikimit të hershëm, vlerësimit objektiv, monitorimit të vazhdueshëm, raportimit transparent dhe ndërmarrjes së masave adekuate për zbutjen e rreziqeve.

Qeverisja e menaxhimit të rrezikut në FKGK është e strukturuar në mënyrë që të sigurojë përgjegjësi të qarta dhe mbikëqyrje efektive në të gjitha nivelet organizative. Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e përgjithshme të profilin të rrezikut të institucionit dhe për miratimin e politikave kryesore të menaxhimit të rrezikut. Komiteti i Rrezikut, Drejtori Menaxhues dhe Njësia e Menaxhimit të Rrezikut sigurojnë zbatimin e këtyre politikave, monitorimin e vazhdueshëm të ekspozimeve dhe adresimin me kohë të çështjeve që lidhen me rrezikun. Njësia e Menaxhimit të Rrezikut mbështet proceset e identifikimit, matjes, monitorimit dhe raportimit të rreziqeve në nivel institucional. Përtëj këtyre strukturave dhe përgjegjësiave formale, FKGK-ja promovon një kulturë të menaxhimit të rrezikut në të gjitha nivelet e organizatës, duke inkurajuar çdo punonjës të kuptojë rolin dhe përgjegjësinë e tij në identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me aktivitetet e përditshme. Menaxhimi i rrezikut në FKGK mbështetet në një sistem të konsoliduar politikash, procedurash dhe metodologjish të brendshme, të cilat rregullojnë proceset e vlerësimit, monitorimit dhe raportimit të rrezikut. Këto dokumente sigurojnë një qasje të standardizuar ndaj menaxhimit të rrezikut dhe përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat e kontrollit në të gjithë institucionin.

Përmes proceseve të rregullta të monitorimit dhe raportimit, FKGK-ja vlerëson vazhdimisht profilin e saj të rrezikut, identifikon ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm operativ, si dhe ndërmerr masa parandaluese ose korrigjuese kur është e nevojshme. Kjo qasje mundëson reagim të hershëm ndaj rreziqeve të identifikuar dhe kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe operacional të institucionit.

RREZIKU KREDITOR I GARANCISË

Rreziku kryesor i FKGK-së buron nga roli dhe veprimtaria e saj në ofrimin e garancive të pjesshme të kredive për NMVM-të përmes Institucioneve të Regjistruara Financiare. Meqenëse IRF-të janë përgjegjëse për vlerësimin, vendimmarrjen dhe menaxhimin e kredive, qasja e FKGK-së për të ushtruar kontroll mbi rreziqet kreditore është e kufizuar. Megjithatë, për adresimin e këtyre sfidave, FKGK-ja ka optimizuar proceset e saj të menaxhimit të rrezikut dhe ka zhvilluar një qasje proaktive ndaj rrezikut në nivel portofoli. Menaxhimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor realizohet përmes një sërë mekanizmash kontrolli, të cilët përfshijnë vlerësimin e kujdesshëm të kërkesave për garanci, analizën e karakteristikave të portofolit të kredive të garantuara, vlerësimin e performancës së IRF-ve, si dhe mekanizma të tjerë të përshtatshëm të kontrollit.

Korniza e menaxhimit të rrezikut kreditor përbehet nga një mekanizëm i mire-organizuar i monitorimit, i cili përfshinë një cikël monitorimi duke filluar nga analizat dhe monitorimi i faktorëve të jashtëm makroekonomikë, faktorëve të sektorit financiar dhe përcjelljen dhe monitorimin e indikatorëve të

brendshëm të rrezikut të përcaktuar nga FK GK-ja. Korniza e menaxhimit të rrezikut mbështet nga raporte të detajuara dhe transparente nga sistemet e menaxhimit të informatave dhe sistemet e raportimit të FK GK-së.

PROCESET GJITHËPËRFSHIRËSE TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT KREDITOR

FK GK-ja ka zbatuar procese gjithëpërfshirëse për menaxhimin e rrezikut kreditor, të cilat synojnë identifikimin në kohë, vlerësimin e duhur dhe zbutjen efektive të rreziqeve potenciale në kuadër të portofolit të garancive. Këto procese përfshijnë:

1. Politikat dhe procedurat	Korniza e politikave për menaxhimin e rrezikut rishikohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë praktika të avancuara për diversifikimin e portofolit, kufizimin e përqendrimit të rrezikut dhe monitorimin efektiv të ekspozimeve.
2. Korniza e Qeverisjes dhe Menaxhimit të Rrezikut	Korniza e qeverisjes së rrezikut siguron mbikëqyrje efektive përmes rolit të Bordit të Drejtorëve, Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, menaxhmentit dhe funksionit të Menaxhimit të Rrezikut, duke garantuar që rreziqet identifikohen, monitorohen dhe menaxhohen në përputhje me politikat, apetitin ndaj rrezikut dhe objektivat strategjike të FK GK-së.
3. Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut	Realizimi i vlerësimeve periodike të portofolit përmes përdorimit të indikatorëve kyç të rrezikut (Key Risk Indicators - KRI) dhe indikatorëve të hershëm paralajmërues (Early Warning Indicators – EWI), me qëllim identifikimin, matjen dhe analizimin proaktiv të rreziqeve potenciale.
4. Monitorimi dhe kontrolli	Monitorimi i vazhdueshëm i portofolit realizohet përmes raporteve mujore të rrezikut, analizave të trendeve, vlerësimeve sektoriale dhe vlerësimeve vjetore të IRF-ve, duke mundësuar identifikimin në kohë të ndryshimeve në performancën e portofolit dhe ndërmarrjen e masave parandaluese.
5. Kalkulimi i provizioneve	Provizionet për humbjet potenciale kalkuloohen në përputhje me politikat e brendshme të provizionimit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, duke reflektuar në mënyrë prudençe (të kujdesshme) nivelin e rrezikut të portofolit dhe duke siguruar mbulim adekuat ndaj humbjeve të mundshme.

FK GK ka zbatuar masa të strukturuar për të siguruar shpërndarje adekuate të rrezikut në disa nivele:

- **Struktura e garancive:** Aplikimi i limiteve të mbulimit të garancisë deri në 50% për klientët NMVM, ndërsa për dritaret strategjike janë ofruar nivele më të larta të mbulimit, deri në 80% për segmente të caktuara të ndjeshme të ekonomisë, duke balancuar mbështetjen zhvillimore me kontrollin e rrezikut.
- **Skema e ri-garancisë:** Shfrytëzimi i linjave të ri-garancisë si instrument për rishpërndarjen e rrezikut duke kontribuar në forcimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme të portofolit të garancive.
- **Leva:** FK GK-ja ka vazhduar të menaxhojë potencialin garantues përmes aplikimit të faktorëve të levës të miratuar për secilën dritare garantuese. Kjo ka mundësuar përdorim më të matur të kapitalit, duke ruajtur një nivel të kujdesshëm të ekspozimit ndaj rrezikut dhe duke siguruar kapacitet të mjaftueshëm për absorbimin e humbjeve potenciale. Niveli i lartë i kapitalizimit dhe leva e kontrolluar përbëjnë elemente kyçe të qëndrueshmërisë financiare të FK GK-së, duke forcuar aftësinë e institucionit për të përballuar humbjet potenciale dhe duke rritur besimin e palëve

të interesit. Menaxhimi i nevojave për kapital mbetet një komponent thelbësor i kornizës së menaxhimit të rrezikut, duke mbështetur kapacitetin afatgjatë të institucionit për përmbushjen e mandatit të tij.

- **Kufizimi i humbjeve (Loss Cap) në nivel të dritareve:** Në kuadër të menaxhimit të rrezikut në nivel portofoli, FK GK-ja aplikon kufizime të parapërcaktuara të humbjeve (loss caps) për dritare të caktuara të garancisë. Ky mekanizëm përcakton një kufi maksimal të humbjeve të pranueshme, duke siguruar kontroll të drejtpërdrejtë mbi ekspozimin total dhe duke mbrojtur qëndrueshmërinë financiare të institucionit, veçanërisht në segmentet me rrezik më të lartë.

- **Diversifikimi i ekspozimit:** Vendosja e kufizimeve dhe kontrolleve të brendshme për të parandaluar përqendrimin e tepërt të rrezikut, përmes:

- Përcaktimit të limiteve të ekspozimit në nivel të institucioneve financiare të regjistruara, si për ekspozimin total, ashtu edhe për secilin institucion individualisht;
- Vendosjes së limiteve të garantimit në nivel të NMVM-ve dhe palëve të lidhura me to;

- Vendosijs së kufizimeve për të shmangur përqendrimet e larta në një industri të vetme; dhe
- Përdorimit të një vargu masash dhe mekanizmash të kontrollit për identifikimin, monitorimin dhe kufizimin e rrezikut të përqendrimit, me qëllim ruajtjen e një portofoli të balancuar dhe të diversifikuar.

Gjithashtu, FK GK-ja ka vazhduar angazhimin në avancimin e digjitalizimit të proceseve dhe funksioneve kyçe, duke kontribuar në rritjen e transparencës institucionale, përmirësimin e efikasitetit operacional si dhe forcimin e kapaciteteve për identifikimin dhe menaxhimin proaktiv të rreziqeve në kohë reale.

CILËSIA E PORTOFOLIT

FK GK ka vazhduar të monitorojë në mënyrë sistematike cilësinë e portofolit të garancive kreditore, duke siguruar një nivel të qëndrueshëm të mbështetjes për institucionet financiare partnere, dhe, njëkohësisht, duke ruajtur stabilitetin e ekspozimit ndaj rrezikut.

Të dhënat deri në fund të muajit dhjetor 2025 tregojnë se përqindja e kredive delikuede ka mbetur në nivele të ulëta dhe të menaxhueshme,

duke shënuar rënie nga 1.35% në dhjetor 2024 në 1.21% në dhjetor 2025. Përqindja e kredive jo-performuese (KJP) gjithashtu ka shënuar përmirësim të dukshëm, duke rënë nga 2.19% në dhjetor 2024, në 1.39% në dhjetor 2025, çka pasqyron një menaxhim efektiv të rrezikut nga FK GK-ja. Njëkohësisht, këto rezultate janë mbështetur edhe nga politikat e shëndosha të kreditimit dhe praktikave të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut të zbatuara nga institucionet financiare partnere, të cilat kanë kontribuar në ruajtjen e cilësisë së portofolit garantues. Në nivelin e raportuar të KJP-ve ka ndikuar pjesërisht edhe largimi nga portofoli garantues i kredive jo-performuese me vlerë të garantuar prej rreth 692 mijë EUR, për të cilat kishte skaduar afati për paraqitjen e kërkesës për pagesë sipas kushteve të Marrëveshjes së Garancisë.

Ky trend pozitiv demonstroi efektivitetin e proceseve të vlerësimit kreditor dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut të zbatuara nga FK GK-ja. Ndërsa, përqindja kumulative e kërkesave për pagesë ndaj totalit të borxhit të mbetur ka shënuar një rritje të lehtë, nga 2.43% në dhjetor 2024 në 2.63% në dhjetor 2025. Pavarësisht kësaj rritjeje, niveli i këtij indikator mbetet i menaxhueshëm dhe reflekton një qasje të kujdesshme në menaxhimin dhe kontrollin e ekspozimit financiar.

Tabela në vijim paraqet trendin e cilësisë së portofolit 2025

Indikatorët e cilësisë	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025	Ndryshimi
Delikuenca	1.35%	1.21%	-0.14 pp
KJP*	2.19%	1.39%	-0.80 pp
Kërkesa për pagesë	2.43%	2.63%	-0.20 pp

* Ulja e nivelit të KJP-ve është ndikuar pjesërisht edhe nga largimi nga portofoli garantues i kredive joperformuese, për të cilat kishte skaduar afati i paraparë me marrëveshje të garancisë për paraqitjen e kërkesës për pagesë (claim).

Në përputhje me objektivin për ruajtjen e një portofoli të balancuar dhe të qëndrueshëm, FK GK-ja ka vazhduar të zbatojë strategjinë e diversifikimit të portofolit të garancive kreditore. Diversifikimi i portofolit mbetet një nga mekanizmat kryesorë të FK GK-së për menaxhimin e rrezikut në nivel portofoli, ku FK GK-ja vlerëson në mënyrë të vazhdueshme strukturën e portofolit sipas madhësisë së kredive, sektorëve ekonomikë, rajoneve gjeografike, institucioneve financiare partnere dhe ekspozimeve individuale.

Portofoli karakterizohet nga një mesatare e kredisë së garantuar prej 50,102 EUR, ndërsa shpërndarja sipas madhësisë së kredive tregon se 26.31% e

kredive janë të përqendruara në segmentin 50,000-100,000, ndërsa pjesa tjetër është e diversifikuar nëpër kategori të tjera, duke reflektuar një bazë të gjerë klientësh dhe një nivel të mirë të shpërndarjes së rrezikut.

Gjithashtu, ekspozimet e mëdha monitorohen në mënyrë të veçantë për të siguruar që asnjë klient, grup i ndërlidhur klientësh apo sektor ekonomik të mos krijojë përqendrim të rrezikut në portofol. Në fund të vitit, ekspozimet e mëdha përfaqësonin 12% të portofolit të garantuar, ndërsa ekspozimi më i madh individual përbënte 1.07% të kapitalit të FK GK-së. Këta tregues, së bashku me koeficientin Gini prej 0.59, tregojnë se portofoli i

garancive karakterizohet nga një nivel i kënaqshëm diversifikimi, duke kontribuar në shpërndarjen e rrezikut dhe në forcimin e qëndrueshmërisë së portofolit. Në përgjithësi, indikatorët e cilësisë së portofolit konfirmojnë qasjen prudente të FKKG-së ndaj menaxhimit të rrezikut si dhe efektivitetin e politikave të brendshme që synojnë ruajtjen e cilësisë së portofolit, minimizimin e humbjeve potenciale dhe mbështetjen e misionit të FKKG-së për rritjen e qasjes në financim për NMVM-të.

SEKTORËT ME KJP MË TË LARTË

Analiza e kredive joperformuese (KJP) sipas sektorëve ekonomikë tregon dallime në nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Të dhënat tregojnë se sektori i ndërtimit paraqet nivelin më të lartë të KJP-ve me 3.05%, i ndjekur nga sektori

i prodhimit me 2.19%, duke reflektuar një nivel relativisht më të lartë të rrezikut në këta sektorë krahasuar me sektorët e tjerë. Nga ana tjetër, sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit paraqet një nivel të moderuar të KJP-ve prej 1.66%, sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë ka një nivel prej 1.01% dhe sektori i shërbimeve me 0.80%. Edhe pse me një nivel më të lartë, sektori i ndërtimit vazhdoi të ketë rol të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik të Kosovës.

Megjithatë ky sektor karakterizohet nga një profil më i lartë i rrezikut kreditor në krahasim me sektorët e tjerë ekonomikë. Kjo performancë lidhet me sfidat strukturore të sektorit, përfshirë rritjen e kostove të ndërtimit dhe materialeve, mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, varësinë nga importet si dhe ndjeshmërinë ndaj luhatjeve ekonomike.

Tabela në vijim paraqet KJP % mujore sipas sektorëve, 2025

Sektori	KJP %, Dhjetor 2025	Pjesëmarrja%
Tregtia me shumicë dhe pakicë	1.01 %	39.61%
Ndërtimtaria	3.05 %	6.54 %
Prodhimi	2.19 %	20.85 %
Bujqësia, Pylltari dhe Peshkimi	1.66 %	8.15 %
Shërbimet	0.80 %	24.85 %
Gjithsej	1.39 %	100 %

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së performancës së sektorëve dhe i nivelit të përqendrimit të ekspozimeve mbetet një objektivi i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut, me qëllim identifikimin në kohë të rreziqeve potenciale dhe ruajtjen e stabilitetit të portofolit të garancive.

REZERVAT E HUMBJEVE TË PRITURA (PROVIZIONET)

Gjatë vitit raportues, totali i provizioneve për humbjet e pritura kreditore (HPK) ka arritur në 4.4 milionë euro, që përfaqëson një mbulueshmëri prej 2.48% ndaj bilancit të përgjithshëm të garantuar prej 179.5 milionë euro.

Struktura e provizioneve tregon se pjesa më e madhe e portofolit mbetet në Fazën 1, me pjesëmarrje prej 96.35% dhe një normë mbulueshmërie prej 1.28%, duke reflektuar cilësi të mirë të portofolit. Ndërkohë, Fazat 2 dhe 3, të cilat përfaqësojnë ekspozime me rrezik më të lartë kreditor, kanë nivele më të larta mbulueshmërie të provizioneve prej 21.79% dhe 53.97%, duke demonstruar një qasje prudente në mbulimin e humbjeve potenciale.

Tabela në vijim paraqet rezervat e provizionimit për portofolin garantues

Gjithsej garanci	Bilanci garantues	Shuma e HPK	Mbulueshmëria me HPK%	Pjesëmarrja %
Faza 1	172,925,354	2,212,971	1.28%	96.35%
Faza 2	4,054,885	883,404	21.79%	2.26%
Faza 3	2,500,060	1,349,320	53.97%	1.39%
Gjithsej	179,480,299	4,445,695	2.48%	100.00%

Krahas portofolit të garancive kreditore, FK GK-ja ka krijuar rezerva të provizionimit edhe për asete të tjera financiare, përfshirë depozitat në institucionet financiare partnere dhe investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Aplikimi i modelit të humbjeve të pritura kreditore (HPK) mundëson një vlerësim më gjithëpërfshirës dhe të bazuar në rrezik të cilësisë së aseteve, duke forcuar qasjen prudente të FK GK-së ndaj menaxhimit financiar.

Në përgjithësi, niveli i provizioneve reflekton një mbulim adekuat të rrezikut kreditor dhe konfirmon qasjen prudente të FK GK-së në menaxhimin e humbjeve të pritura, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe qëndrueshmërisë së portofolit të garancive. Ky model gjithashtu mbështet proceset strategjike të vendimmarrjes, duke shërbyer si komponent i rëndësishëm në përcaktimin e tarifave të garancisë të bazuara në rrezik dhe në sigurimin e një qasjeje të qëndrueshme ndaj menaxhimit të portofolit.

Tabela në vijim paraqet rezervat e provizionimit për asete të tjera

Asete të tjera	Investime	Shuma e HPK	Provizionimi %
Faza 1	113,869,455	366,857	0.35%
Gjithsej	113,869,455	366,857	0.35%

RREZIKU OPERACIONAL

Rreziku operacional në FK GK përfshin rreziqet që burojnë nga proceset e brendshme, sistemet e teknologjisë informative, faktorët njerëzorë, si dhe nga ngjarjet e jashtme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave institucionale. Për menaxhimin efektiv të rrezikut operacional, FK GK-ja ka zbatuar një kornizë të strukturuar të menaxhimit të këtij rreziku, e cila përfshin një strukturë qeverisëse efikase, politika dhe procedura të brendshme me qëllim të identifikimit dhe monitorimit sa më të mirë të rrezikut operacional.

FK GK-ja po ashtu ka vazhduar me procesin e Kontrollit të Rrezikut dhe Vetëvlerësimit, me qëllim identifikimin, analizimin dhe priorizimin e rreziqeve dhe marrjen e vendimeve të duhura për zbatimin e strategjisë për zbutjen e rreziqeve. Në këtë kornizë janë të përfshira edhe databaza e humbjeve operationale, e cila shërben për të regjistruar dhe analizuar informacionet në lidhje me rreziqet operationale, si dhe procesi i miratimit të rreziqeve të reja, si mekanizëm për të vlerësuar dhe miratuar procese dhe produkte apo instrumente të biznesit, të reja apo të ndryshuara ndjeshëm, para se ato të zbatohen, me qëllim të shmangies dhe zvogëlimit të rreziqeve potenciale.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të rregullta të stafit në fushën e menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe pajtueshmërisë (*compliance*), me qëllim rritjen e vetëdijes institucionale ndaj rreziqeve operationale. Kjo qasje kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë operationale dhe në ruajtjen e integritetit të proceseve të FK GK-së.

RREZIKU I LIKUIDITETIT

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit ka rol kyç për FK GK-në, me qëllim sigurimin e disponueshmërisë së mjaftueshme të mjeteve financiare për përmbushjen me kohë të detyrimeve që rrjedhin nga aktiviteti garantues dhe nga operationet e institucionit. FK GK-ja zbaton një qasje prudente në menaxhimin e këtij rreziku, e cila mbështetet në planifikimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të rrjedhës së parasë, projeksionet periodike të hyrjeve dhe daljeve të mjeteve, si dhe vlerësimin e nevojave të ardhshme për financim.

Menaxhimi i mjeteve financiare mbështetet gjithashtu në mbajtjen e rezervave adekuate dhe në investimin e mjeteve të lira në instrumente me rrezik të ulët, duke siguruar diversifikim sipas institucioneve financiare, instrumenteve investuese dhe afateve të maturimit. Struktura e investimeve është dizajnuar për të balancuar sigurinë, disponueshmërinë e mjeteve dhe kthimin e arsyeshëm nga investimet. Për monitorimin e profilit të likuiditetit, FK GK-ja përdor tregues të brendshëm, monitoron nivelin e mjeteve likuide në raport me detyrimet potenciale që rrjedhin nga portofoli i garancive dhe kryen vlerësime periodike të mjaftueshmërisë së tyre.

Gjatë periudhës raportuese, FK GK-ja ka ruajtur një pozitë të qëndrueshme financiare, duke siguruar mbulim të mjaftueshëm të detyrimeve aktuale dhe potenciale, si dhe kapacitet të lartë për përmbushjen me kohë të kërkesave për pagesa të garancive.

Niveli i lartë i kapitalizimit, i kombinuar me rezerva adekuate të likuiditetit dhe me levën e kontrolluar, kontribuon në forcimin e kapacitetit të institucionit për të absorbuar humbjet potenciale dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare në afat të gjatë.

RREZIKU I REPUTACIONIT

Ruajtja e reputacionit institucional është një ndër prioritetet kryesore të FK GK-së, pasi besueshmëria e institucionit përbën bazën e bashkëpunimit me institucionet financiare partnere, donatorët, autoritetet publike dhe palët e tjera të interesit. Duke qenë institucion me rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit financiar, reputacioni i FK GK-së ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e tij për të përmbushur misionin dhe objektivat strategjike.

Në këtë drejtim, FK GK-ja zbaton standarde të larta të qeverisjes korporative, etikës profesionale dhe kontrollit të brendshëm, duke promovuar transparencë, llogaridhënie dhe integritet në të gjitha aktivitetet e saj. Institucioni siguron komunikim të qartë dhe të qëndrueshëm me palët e interesit, raportim të saktë dhe me kohë, si dhe pajtueshmëri me kërkesa ligjore dhe rregullative, me qëllim ruajtjen e besimit dhe kredibilitetit institucional.

Përmes monitorimit të vazhdueshëm të faktorëve që mund të ndikojnë në reputacionin e tij, publikimit të informatave relevante dhe forcimit të bashkëpunimit me partnerët, FK GK-ja synon të ruajë dhe të forcojë pozitën e saj si institucion i besueshëm, transparent dhe profesional, në mbështetje të zhvillimit të sektorit financiar dhe NMVM-ve në Kosovë.

ZHVILLIME DHE SFIDAT E MJEDISIT TË JASHTËM

Gjatë vitit 2025, ekonomia e Kosovës ka vazhduar të operojë në një mjedis të karakterizuar nga pasiguri të vazhdueshme ekonomike dhe gjeopolitike në nivel ndërkombëtar. Megjithatë aktiviteti ekonomik ka mbetur relativisht i qëndrueshëm, zhvillimet në tregjet globale kanë vazhduar të ndikojnë në perspektivën ekonomike dhe në nivelin e rrezikut për sektorin financiar. Presionet inflacioniste, luhatjet në çmimet e energjisë dhe mallrave bazë, ngadalësimi i kërkesës në tregjet kryesore evropiane, si dhe tensionet gjeopolitike në rajone të ndryshme të botës, kanë mbetur faktorë me ndikim potencial në aktivitetin ekonomik dhe investues.

Sipas vlerësimeve të institucioneve ndërkombëtare dhe të Bankës Qendrore të Kosovës, rritja ekonomike në Kosovë ka mbetur pozitive, ndonëse me ritëm më të moderuar krahasuar me periudhat e mëparshme. Inflacioni ka treguar shenja të rikthimit gjatë vitit 2025, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit, energjisë dhe shërbimeve, duke ushtruar presion mbi fuqinë blerëse të bizneseve dhe ekonomive familjare. Në të njëjtën kohë, pasiguritë lidhur me zhvillimet ekonomike në Bashkimin Evropian, nga i cili Kosova varet në masë të konsiderueshme përmes remitencave, investimeve të huaja dhe tregtisë, kanë vazhduar të paraqesin burim potencial rreziku për perspektivën ekonomike të vendit.

Pavarësisht këtyre sfidave, sektori financiar në Kosovë ka demonstruar nivel të lartë rezistence dhe stabiliteti. Sistemi bankar ka ruajtur nivele të kënaqshme të kapitalizimit, likuiditetit dhe cilësisë së portofolit kreditor, duke vazhduar të mbështesë aktivitetin ekonomik përmes kreditimit të sektorit privat. Megjithatë, rritja e konkurrencës për depozita, zgjerimi i aktivitetit kreditues dhe ndryshimet në normat e interesit kërkojnë monitorim të vazhdueshëm të rreziqeve financiare dhe të likuiditetit.

Në këtë kontekst, FK GK-ja ka vazhduar të forcojë kapacitetet e saj për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve që burojnë nga mjedisi i jashtëm. Përmes analizave të rregullta të tregut, monitorimit të treguesve makroekonomikë dhe zhvillimit të mjeteve analitike për vlerësimin e performancës së portofolit, FK GK-ja ka mbështetur procesin e vendimmarrjes me informata të bazuara në rrezik dhe ka mundur reagim më proaktiv ndaj zhvillimeve potencialisht negative.

Kjo qasje ka kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar të FK GK-së, forcimin e qëndrueshmërisë së portofolit garantues dhe mbështetjen e vazhdueshme të qasjes në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë.

KËRKESAT PËR PAGESË DHE RIKUPERIMET NGA KREDITË E DËSHTUARA

MENAXHIMI I KËRKESAVE PËR PAGESË NGA KREDITË E DËSHTUARA DHE RIKUPERIMEVE

Gjatë vitit 2025, FKGGK-ja vazhdoi të përmirësojë procedurat operative për menaxhimin e kërkesave për pagesë dhe rikuperimin e kredive të garantuara, me synim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe konsistencës në administrimin e këtyre proceseve.

Përmes standardizimit të procedurave, forcimit të mekanizmave të brendshëm, përdorimit të sistemeve digjitale dhe bashkëpunimit të ngushtë me Institucionet e Regjistruara Financiare (IRF), FKGGK-ja përmirësoi ndjeshëm cilësinë dhe shpejtësinë e trajtimit të kërkesave për pagesë dhe procesit të rikuperimit të mjeteve, duke forcuar njëkohësisht besueshmërinë e skemës së garancisë kreditore dhe administrimin e shëndoshë të portofolit të garantuar.

PERFORMANCA E KËRKESAVE PËR PAGESË DHE RIKUPERIMEVE GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, FKGGK-ja ka paguar 107 kërkesa për pagesë në vlerë totale prej 1.41 milion euro. Niveli i pagesave ka mbetur nën parashikimin vjetor prej 2.2 milionë eurosh, për të cilat institucioni kishte siguruar kapacitetet e nevojshme financiare, duke reflektuar një performancë më të favorshme të portofolit të garantuar sesa ishte planifikuar.

Analiza e kërkesave për pagesë sipas sektorëve ekonomikë tregon se sektori i tregtisë përfaqëson 29.44% të kërkesave të paguara, ndërsa në portofolin e garantuar ky sektor përbën 39.6% të kredive të garantuara. Në mënyrë të ngjashme, sektori i prodhimit përfaqëson 19.65% të kërkesave për pagesë, krahasuar me një pjesëmarrje prej 20% në portofolin e garantuar, sektori i ndërtimtarisë përbën 15.86% të kërkesave për pagesë, ndonëse përfaqëson vetëm 6% të kredive të garantuara, duke sugjeruar një nivel më të lartë të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor krahasuar me sektorët e tjerë. Po ashtu, sektori i bujqësisë përfaqëson 14.68% të kërkesave për pagesë, ndërsa përbën vetëm 8% të portofolit të garantuar.

Pjesa e mbetur prej 17.88% e kërkesave për pagesë është e shpërndarë në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Sa i përket shpërndarjes rajonale, kërkesat për pagesë janë të përqendruara kryesisht në rajonin e Prishtinës, me 20.98%, pasuar nga Ferizaj me 17.77%, Peja me 13.45% dhe Fushë Kosova me 13.41%. Pjesa tjetër e kërkesave për pagesë është shpërndarë në rajonet e tjera të vendit.

Gjatë vitit janë refuzuar pesë kërkesa për pagesë, prej të cilave tri janë refuzuar për shkak të tejkalimit të përqindjes së parapagimit të përcaktuar në Marrëveshjen e Garancisë, ndërsa dy të tjera për shkak të klasifikimit jokualifikues në CRK. Numri i ulët i refuzimeve tregon një nivel të lartë të pajtueshmërisë së institucioneve financiare partnere me kërkesat e skemës së garancisë.

Sa i përket kthimeve, gjatë vitit 2025 janë rikuperuar 317,197.77 euro. Pjesëmarrjen më të lartë në rikuperime e ka shënuar sektori i ndërtimtarisë me 38.32%, duke treguar performancën më të mirë në kthimin e mjeteve pas pagesës së garancisë. Sektori i tregtisë ka kontribuar me 17.85%, prodhimi me 15.77% dhe bujqësia me 10.18%, ndërsa pjesa tjetër e rikuperimeve është realizuar nga sektorë të ndryshëm ekonomikë.

Shpërndarja e rikuperimeve sipas rajoneve tregon një përqendrim më të lartë në Suharekë, e cila përbën 36.66% të rikuperimeve, e pasuar nga Prishtina me 20.93%, Prizreni me 8.59%, Ferizaj me 6.75%, Peja me 3.39% dhe Fushë Kosova me 1.30%. Pjesa e mbetur e rikuperimeve është realizuar në rajone të tjera të vendit.

Në përgjithësi, rezultatet e vitit 2025 tregojnë se niveli i kërkesave për pagesë ka mbetur nën parashikimet, ndërsa procesi i rikuperimeve ka vazhduar të gjenerojë kthime të konsiderueshme. Analiza sipas sektorëve dhe rajoneve ofron një pasqyrë më të qartë të shpërndarjes:

Tabela në vijim paraqet analizën sipas sektorëve

ANALIZA SIPAS SEKTORËVE		
Sektori	Kërkesa për pagesë nga kreditë e dështuara %	Rikuperimi %
Tregtia	29.44%	17.85%
Ndërtimtaria	15.86%	38.32%
Prodhimi	19.65%	15.77%
Bujqësia	14.68%	10.18%
Të tjerë	20.23%	17.88%

Tabela në vijim paraqet analizën sipas komunave

ANALIZA SIPAS KOMUNAVE		
Komuna	Kërkesa për pagesë nga kreditë e dështuara %	Rikuperimi %
Prishtina	20.98%	20.93%
Ferizaj	17.77%	6.75%
Peja	13.45%	3.39%
Fushë Kosova	13.41%	1.30%
Suhareka	2.82%	36.66%
Prizreni	3.13%	8.59%
Të tjerë	28.44%	22.28%

Shpërndarja sipas sektorëve dhe rajoneve e bën raportin më të qartë gjatë krahasimit të kërkesave për pagesë të paguara me rikuperimet, pasi na tregon jo vetëm se ku po ndodhin humbjet, por edhe se ku po rikuperohen më mirë mjetet pas pagesës së garancisë. Që nga fillimi i operimit të skemës së garancisë, FKGGK-ja ka paguar gjithsej 4,716,278 euro, të shpërndara në 353 kërkesa për pagesë. Të gjitha kërkesat për pagesë janë trajtuar në përputhje të plotë me marrëveshjet e garantimit dhe politikat e brendshme të FKGGK-së, duke siguruar transparencë dhe integritet gjatë gjithë procesi.


Tabela në vijim paraqet vlerën e kërkesave të paguara

Viti	Nr	Vlera e kërkesave të paguara (EUR)
2019	4	82,351.06€
2020	16	228,895.10€
2021	20	223,304.13€
2022	44	572,603.54€
2023	60	851,873.00€
2024	102	1,345,012.55€
2025	107	1,412,239.00€
Gjithsej	353	4,716,278.38€

Paralelisht me menaxhimin e kërkesave për pagesë, FKGGK-ja ka vazhduar të avancojë procesin e rikuperimeve e mjeteve, duke vendosur fokus të veçantë në monitorimin e rasteve të paguara dhe koordinimin me IRF-të.

Si rezultat i këtyre përpjekjeve, gjatë vitit 2025 janë rikuperuar 317,198 euro, që përbën nivelin më të lartë vjetor të rikuperimeve të realizuara deri më sot. Kjo ka bërë që shuma totale e rikuperimeve, që nga fillimi i procesit të rikuperimit, të arrijë në 547,060 euro.

Grafi në vijim paraqet shumën e rikuperuar ndër vite



Përveç përmirësimit të performancë në rikuperime, FKGGK-ja ka vazhduar të forcojë mekanizmat e monitorimit të rasteve të paguara përmes vizitave në teren. Krahas komunikimit dhe koordinimit të vazhdueshëm me IRF-të, janë realizuar aktivitete monitoruese tek klientët për të cilët FKGGK-ja ka ekzekutuar pagesat e kërkesave.


Këto aktivitete kanë shërbyer për vlerësimin e gjendjes së klientëve pas pagesës së kërkesave, identifikimin e mundësive shtesë për rikuperim dhe sigurimin e informacionit më të plotë për menaxhimin e rasteve nga ana e IRF-ve. Ky angazhim ka kontribuar në forcimin e mbikëqyrjes së portofolit të kërkesave të paguara, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e efektivitetit të procesit të rikuperimit.

Këto rezultate dëshmojnë përkushtimin e FKGGK-së për menaxhimin efikas të rrezikut pas pagesës së kërkesës, duke balancuar përbushjen e detyrimeve ndaj institucioneve financiare me përpjekjet për rikuperimin e mjeteve dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së skemës së garancisë.

EFIKASITETI NË KOHËN E PROCESIMIT TË KËRKESAVE PËR PAGESË

Përveç forcimit të proceseve të monitorimit dhe rikuperimit, gjatë vitit 2025 FK GK-ja ka vazhduar të përmirësojë edhe kohën e procesimit të kërkesave për pagesë. Falë optimizimit të proceseve të brendshme dhe përdorimit më efektiv të sistemeve digjitale, koha mesatare e procesimit të kërkesave është ulur 9.2 ditë në vitin 2024 në 7.1 ditë në vitin 2025. Ky përmirësim ka mundësuar reagim më të shpejtë ndaj kërkesave për pagesë të IRF-ve dhe ka kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga FK GK-ka.

Grafi në vijim paraqet ditët e procesimit



Koha e procesimit paraqet periudhën e nevojshme për trajtimin dhe finalizimin e një kërkesë për pagesë, duke filluar nga data e kompletimit të dokumentacionit nga institucioni financiar e deri në realizimin e pagesës.

Kjo periudhë përfshin të gjitha fazat e procesit, përfshirë analizën e kërkesës, shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës, marrjen e opinionit ligjor, vendimmarrjen në përputhje me procedurat e brendshme, si dhe ekzekutimin e pagesës nga Departamenti i Financave. Ky tregues pasqyron efikasitetin e procesit të trajtimit të kërkesave për pagesë dhe nivelin e koordinimit ndërmjet njësive përkatëse të institucionit.

Viti 2025 shënoi progres të rëndësishëm në menaxhimin e kërkesave për pagesë dhe rikuperimeve, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të FK GK-së për përmirësimin e proceseve, shkurtimin e kohës së procesimit të kërkesave për pagesë dhe menaxhimin e kujdesshëm të portofolit të garantuar.

Rritja e vlerës së kërkesave të paguara, niveli i lartë i rikuperimeve dhe avancimi i mekanizmave të monitorimit dëshmojnë konsolidimin e kapaciteteve institucionale dhe efektivitetin e masave të ndërmarra. Këto arritje kanë forcuar më tej besimin e partnerëve financiarë në skemën e garancisë, duke rritur kredibilitetin e FK GK-së si partner strategjik dhe duke kontribuar në stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar në Republikën e Kosovës.

FINANCAT, THESARI DHE ADMINISTRATA

NJË VIT I RITJES SË QËNDRUESHME DHE OPTIMIZIMIT TË PERFORMANCËS FINANCIARE

Viti 2025 shënoi vazhdimin e rritjes dhe zhvillimit të FK GK. Performanca gjatë këtij viti reflekton një rritje të balancuar të të hyrave, menaxhim të kujdesshëm të rrezikut dhe disiplinë të vazhdueshme në kontrollin e shpenzimeve, duke forcuar qëndrueshmërinë institucionale dhe kapacitetin garantues të FK GK.

Rritja e portofolit të garancive, optimizimi i strukturës së investimeve dhe efikasiteti operacional kanë kontribuar në një rezultat financiar pozitiv, ku 65% e të hyrave totale janë mbajtur si fitim për vitin, duke rritur më tej kapitalin dhe aftësinë e FK GK për të zgjeruar mbështetjen ndaj ndërmarrjeve në Kosovë.

PERFORMANCA FINANCIARE DHE STRUKTURA E TË HYRAVE

Gjatë vitit 2025, FK GK gjeneroi 6 milionë euro të hyra. Struktura e të hyrave mbeti e diversifikuar dhe e qëndrueshme, me një kontribut të balancuar ndërmjet aktivitetit të garantimit dhe aktiviteteve investuese. Të hyrat nga tarifat e garancisë përbënin rreth 41% të të hyrave totale, duke shënuar një rritje vjetore prej 15%, si rezultat i zgjerimit të portofolit të kredive të garantuara.

Të hyrat nga interesi i investimeve përbënin 52% të të hyrave totale dhe përfaqësonin burimin kryesor të të ardhurave gjatë vitit 2025. Kjo rritje u nxit nga vëllimi më i lartë i investimeve, si dhe nga rritja e moderuar e normave të interesit në treg. Në rritjen e të hyrave kontribuan edhe rikuperimet nga institucionet financiare partnere dhe nga ri-garantuesit, të cilat përbënin 6% të të hyrave totale, duke reflektuar përmirësimin e proceseve të rikuperimit dhe të menaxhimit të ekspozimeve ekzistuese.

Shpenzimet totale përbënin 35% të të hyrave, duke dëshmuar një kontroll efektiv të kostove gjatë zgjerimit të aktivitetit. Sa i përket strukturës së shpenzimeve, shpenzimet për provizione përbënin 24% të të hyrave totale dhe u rritën me 46% krahasuar me vitin paraprak, në përputhje me rritjen e portofolit të garancive.

Shpenzimet e personelit u rritën si rezultat i rekrutimit të punonjësve të rinj në pozita të specializuara dhe menaxheriale, për të mbështetur zgjerimin e operacioneve.

Megjithatë, ato mbetën të qëndrueshme në raport me të hyrat totale, duke përbërë rreth 6% të tyre, çka reflekton një strukturë të balancuar të kostove.

Shpenzimet operative (OPEX) shënuan rritje në vlerë absolute si pasojë e zgjerimit të aktivitetit, por mbetën të qëndrueshme në raport me të hyrat, në nivelin prej rreth 4%, duke dëshmuar disiplinë të vazhdueshme në menaxhimin e burimeve.

STRUKTURA E KAPITALIT

Kapitalizimi i institucionit mbetet një prioritet kyç për fuqizimin e potencialit garantues të FK GK-së dhe sigurimin e stabilitetit në tregun financiar. FK GK-ja zbaton një strategji të kujdesshme për menaxhimin dhe përdorimin e kapitalit, bazuar në vlerësimin e rreziqeve në sektorin financiar, me qëllim që kapitali i saj të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur aktivitetet kryesore dhe për të absorbuar humbjet e mundshme.

Struktura financiare e institucionit pasqyron këtë qasje, ku rreth 95% e vlerës së përgjithshme të kapitalit dhe detyrimeve përbëhet nga kapitali i dhuruar dhe fitimet e akumuluar ndër vite. Kjo strukturë reflekton një pozicion të qëndrueshëm financiar dhe siguron kapacitet të konsiderueshëm për përballimin e rreziqeve dhe humbjeve të mundshme.

Pjesa e mbetur përbëhet nga detyrime, ku rezervat për humbjet nga garancitë përfaqësojnë komponentin kryesor. Duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit garantues, vlerësimi i kapitalizimit të institucionit përfshin edhe ekspozimet jashtë bilancit ("off-balance sheet"), të përfaqësuara nga garancitë aktive.

Më 31 dhjetor 2025, portofoli i garancive aktive arriti në 179.5 milionë euro, ndërsa kapitali i përgjithshëm ishte 109.2 milionë euro. Kjo përfaqëson një raport ndërmjet garancive aktive dhe kapitalit prej 1.64, duke reflektuar një nivel të kujdesshëm të levës financiare dhe një kapacitet adekuat kapitali për mbulimin e ekspozimeve të ndërmarra.

Ky nivel i lartë i kapitalizimit rrit aftësinë e institucionit për të absorbuar humbje të papritura, mbështet qëndrueshmërinë financiare dhe kontribuon në përmbushjen e objektivave strategjike në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Tabela në vijim paraqet zhvillimet në strukturën e kapitalit ndër vite

	Qeveria e Republikës së Kosovës	USAID	KfW	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
Kapitali 2016	2,000,000 €	5,345,141 €	-	(3,149) €	7,341,992 €
Kapitali 2017	1,000,000 €	445,780 €	7,000,000 €	179,017 €	8,624,797 €
Kapitali 2018	-	-	-	320,012 €	320,012 €
Kapitali 2019	-	-	-	484,334 €	484,334 €
Kapitali 2020	21,410,000 €	-	11,500,000 €	66,312 €	32,976,312 €
Kapitali 2021	-	-	5,600,000 €	(430,202) €	5,169,798 €
Kapitali 2022	-	-	-	2,818,066 €	2,818,066 €
Kapitali 2023	22,631,590 €	-	-	926,061 €	23,557,651 €
Kapitali 2024	20,368,410 €	-	-	3,177,602 €	23,546,012 €
Kapitali 2025	-	-	258,295 €	4,137,330 €	4,395,625 €
Gjithsej	67,410,000 €	5,790,921 €	24,358,295 €	11,675,383 €	109,234,599 €
%	62%	5%	22%	11%	100%

KONTRIBUTET DHE FONDET

FKGK-ja nuk shpërndan dividendë. Çdo fitim i realizuar ri-kapitalizohet, duke rritur kështu kapitalin dhe duke fuqizuar kapacitetin e institucionit për të ofruar më shumë garanci kreditore në të ardhmen.

Ky raport shërben si një pasqyrë e angazhimit të FKGK-së për përmirësimin e infrastrukturës financiare dhe rritjen e qasjes në financim për bizneset në Kosovë, duke theksuar njëkohësisht rolin jetik të mbështetjes nga Qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë.

Kapitali i FKGK-së përbëhet kryesisht nga kontributet financiare të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet kontribuuesi kryesor, duke siguruar 62% të kapitalit të FKGK-së. KfW-ja, si kontribuuesi i dytë për nga madhësia, ka siguruar 22% të kapitalit, ndërsa USAID-i ka kontribuar me 5% të kapitalit total.

Pjesa e mbetur prej 11% përbëhet nga fitimet e akumuluar ndër vite, duke reflektuar një trend të rritjes progresive të fitimeve dhe fuqizimin e kapitalit të institucionit.

STRUKTURA E ASETEVE DHE MENAXHIMI I LIKUIDITETIT

Struktura e asetëve të FKGK-së dominohet nga investimet në depozita dhe letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2025, totali i asetëve u rrit me 4%, duke arritur në 115 milionë euro. Kjo rritje pasqyron zgjerimin e aktivitetit, rritjen e investimeve dhe forcimin e pozicionit financiar të institucionit. Në përputhje me mandatin ligjor, FKGK investon një pjesë të kapitalit të vet në institucione financiare partnere, duke gjeneruar të ardhura nga interesat e fituara për mbulimin e shpenzimeve operative. Të hyrat nga investimet regjistrohen në Pasqyrën e të Ardhurave, ndërsa çdo tepërcë vjetore riinvestohet ose ruhet brenda kapitalit të FKGK-së.




Kjo qasje reflekton besimin e ndërsjellë ndërmjet FKGK-së dhe institucioneve financiare partnere, të cilave u besohet menaxhimi i mjeteve të investuara. Në të njëjtën kohë, përmes strategjisë së saj të investimeve, FKGK synon të kontribuojë në rritjen e likuiditetit në tregun financiar dhe në nxitjen e zgjerimit të aktivitetit kreditues nga institucionet financiare. Duke ruajtur një balancë të kujdesshme ndërmjet sigurisë dhe kthimit, FKGK optimizon normat e kthimit nga investimet, pa cenuar stabilitetin e përgjithshëm financiar të institucionit.

Gjatë vitit 2025, FK GK vazhdoi zbatimimin e një strategjie të kujdesshme investimi, me fokus në sigurinë e mjeteve, kthimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e një niveli adekuat të likuiditetit.

Portofoli i investimeve në depozita gjatë vitit 2025 u rrit me 4.2%, duke arritur vlerën prej 71 milionë eurosh. Këto investime, me maturitet njëvjeçar, dyvjeçar dhe trevjeçar, u realizuan në institucione financiare partnere, duke vijuar kështu bashkëpunimin e qëndrueshëm të ndërtuar ndër vite. Po ashtu, portofoli i investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, shënoi rritje prej 4.5%, duke arritur vlerën prej 30 milionë eurosh, me maturitet trevjeçar dhe pesëvjeçar.

Si rezultat i rialokimit të mjeteve drejt instrumenteve financiare që gjenerojnë interes, mjetet monetare dhe depozitat në banka u reduktuan me 8%, duke optimizuar kthimin mbi kapitalin, pa kompromentuar nivelin e nevojshëm të likuiditetit.

Grafet në vijim paraqesin: Investimet në depozita; Depozitat me afat sipas maturitetit; Letrat me vlerë sipas maturitetit.



MENAXHIMI I FINANCAVE DHE KONTROLLI

Gjatë vitit 2025, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FK GK) ka vazhduar zbatimimin e proceseve të fuqizuara të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, të zhvilluara gjatë viteve paraprake, duke ruajtur fokusin në transparencë, integritet dhe efikasitet institucional. Në këtë kuadër, është realizuar përditësimi i Politikës së Menaxhimit Financiar, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës financiare dhe përafrimit të saj me nevojat operacionale të institucionit.

Për të siguruar një sistem efektiv dhe efikas të kontrollit të brendshëm, FK GK ka vazhduar zbatimimin e parimeve kryesore, si:

Ndarja e qartë e përgjegjësi dhe funksioneve

– për të shmangur konfliktet e interesit dhe për të garantuar që asnjë person apo njësi organizative të mos ketë kontroll të plotë mbi të gjitha aspektet e një transaksioni.

Dokumentimi dhe standardizimi i proceseve

– për të garantuar konsistencë, transparencë dhe mundësi të lehtë për auditim dhe verifikim të veprimeve të ndërmarra.

Mbikëqyrja dhe raportimi i rregullt

– përmes auditimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe përmes mbledhjes sistematike të të dhënave mbi performancën dhe pajtueshmërinë me kërkesat rregullative financiare.

Analiza e rrezikut dhe masat korrigjuese

– përmes identifikimit proaktiv të rreziqeve financiare dhe operacionale, si dhe zbatimit të masave për zbutjen e tyre në kohën e duhur.

Rishikimi periodik i politikave dhe procedurave

– për të siguruar që ato mbeten në përputhje me kërkesat ligjore, praktikatat më të mira dhe zhvillimet institucionale.

Këto masa kanë kontribuar jo vetëm në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të FK GK-së, e cila e mbylli vitin 2025 me fitim neto prej 4.1 milionë eurosh, por edhe në rritjen e besimit të partnerëve strategjikë dhe institucioneve financiare.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve, FK GK ka forcuar më tej rolin e saj si një instrument kredibil për zhvillimin ekonomik dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë.

INVESTIMI NË BURIME NJERËZORE

Investimi në burimet njerëzore mbetet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit institucional të FKGK-së, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm për forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe përmirësimin e performancës institucionale. Përmes trajnimeve, programeve të certifikimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete profesionale vendore dhe ndërkombëtare, FKGK synon të sigurojë një ekip të kualifikuar dhe të përgatitur për përmbushjen e objektivave strategjike të institucionit.

Gjatë vitit, u ndërmorën iniciativa të rëndësishme për ngritjen profesionale të stafit në fusha prioritare për institucionin. Përfaqësues të FKGK-së morën pjesë në Takimin Vjetor të Shoqatës Evropiane të Institucioneve Garantues ("AECM"), si dhe në sesionin e trajnimit operacional të organizuar nga kjo shoqatë, duke përfituar nga shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira evropiane në fushën e skemave të garancisë.

U zhvilluan trajnime në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit ("AML/CFT"), me qëllim të forcimit të njohurive dhe kapaciteteve profesionale të stafit në këtë fushë. Po ashtu, u përfundua certifikimi në Strategjinë e Marketingut Digjital nga "Harvard Business School Online".

Për më tepër, përfaqësues të institucionit morën pjesë në konferenca profesionale në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në konferencën për kontabilitetin digjital, duke kontribuar në përditësimin e njohurive dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Gjithashtu, u organizua punëtorja "team building" për forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit të brendshëm të ekipit, si dhe trajnim për menaxhimin e projekteve.

Këto aktivitete pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Kostoja totale e trajnimeve dhe zhvillimit profesional të stafit gjatë vitit arriti në rreth 33 mijë euro, duke reflektuar investimin e vazhdueshëm të FKGK-së në ngritjen e standardeve profesionale dhe përmirësimin e performancës institucionale.

FORCIMI I KAPITALIT NJERËZOR NË MBËSHTETJE TË ZGJERIMIT INSTITUCIONAL

Gjatë vitit 2025, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore vazhdoi të mbajë zhvillimin e burimeve njerëzore në qendër të strategjisë së tij institucionale duke e konsideruar kapitalin njerëzor si një faktor kyç për rritjen e qëndrueshme dhe menaxhimin efektiv të zgjerimit të operacioneve. Në përputhje me rritjen e portofolit dhe kompleksitetin në rritje të aktivitetit garantues, gjatë vitit 2025 u punësuan pesë (5) profesionistë të rinj në pozita të larta dhe të specializuara. Integrimi i stafit të ri u mbështet përmes programeve të strukturuar të orientimit dhe trajnimit fillestar (on-boarding).

BARAZIA GJINORE NË FKGK

FKGK-ja mbetet e përkushtuar ndaj promovimit të barazisë gjinore dhe krijimit të një mjedisi pune gjithëpërfshirës, të bazuar në respekt, diversitet dhe mundësi të barabarta për të gjithë punonjësit. Gjatë vitit raportues, FKGK-ja kishte gjithsej 17 anëtarë të stafit, prej të cilëve 13 (76%) ishin gra dhe 4 (24%) ishin burra. Kjo përbërje gjinore pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për promovimin e përfaqësimit dhe fuqizimit të grave, si dhe për kultivimin e një kulture organizative të bazuar në meritokraci dhe përfshirje.

KORNIZA LIGJORE, RREGULLATIVE DHE E PAJTUESHMËRISË

Fondi Kosovë për Garanci Kreditore është institucion juridik i pavarur, i themeluar me ligj. FKKG vepron jashtë strukturave qeveritare të Kosovës dhe shërbimit civil të Kosovës, duke siguruar pavarësinë institucionale dhe efikasitetin në vendimmarrje. Në ushtrimin e mandatit të tij, FKKG gëzon autonomi të plotë operacionale dhe administrative, përfshirë autorizimet për nxjerrjen e legjislacionit sekondar. Në këtë drejtim, FKKG miraton statutin e tij, politika, procedura, udhëzime dhe akte të tjera të brendshme, të cilat përbëjnë kornizën rregullative ligjore sekondare të tij.

Në baza vjetore, institucioni rishikon aktet e brendshme nënligjore për të vlerësuar nevojën për modifikime ose për hartimin e akteve të reja që përputhen me zhvillimet operative dhe objektivat strategjike të tij. Në vitin 2025, në përputhje me objektivat strategjike të tij dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara me palët e treta, FKKG realizoi një sërë aktivitete të rëndësishme që kontribuan në përmirësimin e proceseve të brendshme, arritjen e qëllimeve dhe mandatit të tij institucional.

Aktivitetet dhe arritjet kryesore në fushën ligjore dhe rregullative përfshijnë fushën e legjislacionit sekondar, monitorimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, mbrojtjen e të dhënave personale, marrëveshjet me donatorë dhe palë të treta, dhe krijimin e metodologjisë së provizionimeve ligjore.

PLOTËSIMI I KUADRIT LIGJOR SEKONAR TË FKKG-SË

FKKG ka vazhduar me plotësimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor sekondar, me fokus në forcimin e strukturës rregullative dhe operacionale. Në vitin 2025 është rishikuar Statuti i FKKG-së, janë bërë ndryshimet dhe plotësimet në shtatë politika dhe një procedurë, përfshirë politikën dhe procedurën e rrezikut të garancive kreditore, politikës së burimeve njerëzore, politikës së prokurimit, politikës së menaxhimit mjedisor dhe social.

Ndryshimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor sekondar ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe sigurisë juridike të FKKG-së. Njëkohësisht, këto ndryshime kanë kontribuar në përmirësimin e kornizës për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe operacional, në avancimin e

standardeve institucionale në fushat operacionale, në mbështetjen e realizimit të objektivave strategjike të institucionit, përmirësimin e proceseve të brendshme të burimeve njerëzore, rregullave të prokurimit dhe përmbushjen e standardeve të reja në fushën e qeverisjes mjedisore dhe sociale.

Gjithashtu, janë negociuar dhe formalizuar ndryshimet në marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnere të FKKG-së dhe në marrëveshjet e garancisë me IRF-të. Qëllimi i ndryshimeve ishte përmirësimi i kriterëve dhe kushteve për nxitjen e shfrytëzimit të garancive kreditore, veçanërisht të dritareve strategjike të garancisë, siç janë Dritarja për Gratë në Biznes, Dritarja për Start-Up, Dritarja për Eksport dhe Dritarja GROW.

MIRATIMI I MARRËVESHJEVE TË REJA GARANCISË, NDRYSHIMI I MARRËVESHJEVE ME INSTITUCIONE PARTNERE DHE VENDIME TË TJERA

FKKG synon përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara përmes skemës së garancisë kreditore. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë ndryshime në kriteret dhe kushtet me qëllim stimulimin e përdorimit të dritareve të garancisë dhe përmirësimin e kushteve të qasjes në financa për përfituesit e fundit.

Këto ndryshime janë mbështetur përmes modifikimeve të marrëveshjeve të garancisë me IRF-të, si dhe përmes ndryshimeve dhe harmonizimit të marrëveshjeve me institucionet partnere ndërkombëtare.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe rritjes së përdorimit të Dritares së Gjellbër, FKKG në koordinim me KfW, ndryshoi kriteret e kualifikueshmërisë për këtë dritare dhe nënshkroi marrëveshje të reja të garancisë me IRF-të. Në kuadër të dritareve Start-up dhe Gratë në Biznes, FKKG nënshkroi marrëveshje të reja të garancisë me IRF-të, duke reflektuar kushtet e reja lehtësuese të garancisë, me qëllim të përmirësimit të aksesit në financim për grupet përfituese të këtyre skemave.

FKKG zgjeroi bashkëpunimin me institucionet mikrofinanciare KEP Trust dhe Kreditimi Rural i Kosovës (KRRK), përmes miratimit të marrëveshjeve të reja të garancisë në kuadër të dritareve Standard, Start-up dhe Gratë në Biznes, duke forcuar kështu rrjetin e partnerëve financiarë dhe mbulimin e tregut. Po ashtu, FKKG miratoi regjistrimin e plotë të PriBank si IRF dhe nënshkroi marrëveshjet përkatëse të garancisë, duke zgjeruar më tej bazën e bashkëpunimit institucional.

Në funksion të rritjes së ndikimit të skemave të garancisë dhe lehtësimit të kushteve të financimit për kredimarrësit, FKKG miratoi tarifën e reja të garancisë, respektivisht uljen e tarifave në të gjitha dritaret e garancisë. Vendimi për uljen e tarifave të garancisë ka pasur për qëllim të kontribuojë në ofrimin e kredive me kushte më të favorshme dhe në përmirësimin e qasjes në financa për përfituesit finalë të garancisë kreditore.

Këto arritje dhe aktivitete, jo vetëm që kontribuan në përmbushjen e objektivave strategjike të FKKG-së, por, gjithashtu, forcuan kapacitetet institucionale dhe rritën besueshmërinë ndaj partnerëve dhe palëve të interesuara.

Ndër vendimet më të rëndësishme të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2025 ishin:

- Miratimi i Amendamentit të Marrëveshjes së Veçantë për Projektin e Komponentes 2 – Covid-19: Rimëkëmbja e Gjellbër, të datës 25.11.2021 e nënshkruar në mes KfW- Frankfurt am Main dhe FKKG dhe ndryshimet e kriterëve të kualifikueshmërisë në Dritaren "GROW".
- Miratimi i Amendamentit të Marrëveshjes së Garancisë së Portofolit të Kredive në mes FKKG dhe DFC.
- Miratimi i Amendamentit të Marrëveshjes së Portofolit të Ri-Garancisë Nr. 14881 ndërmjet FKKG dhe Sida.
- Miratimi i Marrëveshjeve të reja të Garancisë për Dritaren Start-Up dhe Gratë në Biznes me IRF.
- Miratimi i Propozimit për nënshkrimin e Marrëveshjeve të Garancisë për Dritaren Standard, Start-Up dhe Gratë në Biznes në mes FKKG-së dhe Institucionit Mikrofinanciar "KEP Trust".
- Miratimi i Propozimit për nënshkrimin e Marrëveshjeve të Garancisë për Dritaren Standard, Start-Up dhe Gratë në Biznes në mes FKKG-së dhe Institucionit Mikrofinanciar "KRK".
- Miratimi i Tarifave të reja të Garancisë për IRF-të.
- Regjistrimi i plotë i Institucionit Financiar "PriBank" për pjesëmarrje në garancitë kreditore të FKKG-së.

AVANCIMI I PROCESIT TË MONITORIMIT NË FUSHËN E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIT TË TERRORIZMIT

FKKG ka forcuar procesin e monitorimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (tutje "PPP/LFT"). Edhe pse nuk ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me kredimarrësit (si përfitues të fundit të garancive kreditore), FKKG ka monitoruar dhe verifikuar procesin që IRF-të zbatojnë, politikat dhe procedurat e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet rregullative në fuqi.

FKKG ka rishikuar dokumentacionin përkatës të IRF-ve dhe në baza të rregullta ka monitoruar kreditë e kualifikuara sipas kategorive të rrezikut dhe statusit të kredimarrësve si persona të ekspozuar politikisht.

Po ashtu, ka kryer vlerësim vjetor të IRF-ve dhe ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët e pajtueshmërisë për çështje të lidhura me PPP/LFT, duke monitoruar njëkohësisht përmbushjen e obligimeve kontraktuale ndaj donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Në funksion të ngritjes së njohurive dhe vetëdijesimit, FKKG ka organizuar një trajnim për stafin në fushën e PPP/LFT.

ZBATIMI I POLITIKËS SË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

FKKG ka zbatuar politikën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke siguruar që të gjitha dokumentet dhe informacionet personale të përpunohen, ruhen dhe shpërndahen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë masash për të forcuar sigurinë dhe pajtueshmërinë me standardet e mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë: monitorimin e vazhdueshëm të proceseve të ruajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave dhe raportimin e tyre në përputhje me politikën e FKKG-së dhe legjislacionin përkatës, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve për pajtueshmëri me rregullat e mbrojtjes së të dhënave, duke siguruar një kulturë organizative që respekton privatësinë dhe sigurinë e informacionit.

Masat e marra kanë kontribuar në rritjen e sigurisë dhe në forcimin e kulturës institucionale dhe pajtueshmërisë me standardet ligjore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.

MONITORIMI DHE ZBATIMI I MARRËVESHJEVE ME DONATORËT DHE PALËT E TRETA

FKGK ka vazhduar procesin e monitorimit sistematik të marrëveshjeve dhe kontratave me donatorët, institucionet financiare dhe palët e treta, me qëllim të sigurimit të zbatimit efektiv të obligimeve kontraktuale.

Ky proces përfshiu:

- vlerësimin e përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga institucionet partnere;
- monitorimin e vazhdueshëm të implementimit të marrëveshjeve;
- organizimin e takimeve të brendshme periodike për shqyrtimin e statusit të zbatimit nga njësitë dhe personat përgjegjës brenda FKGK-së;
- raportimi i përmbushjes së zbatimit të tyre.

Këto masa kanë përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe koordinimin e brendshëm në procesin e monitorimit, duke forcuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe partneritetin me donatorët dhe palët e treta.

KRIJIMI I METODOLOGJISË SË PROVIZIONIMEVE LIGJORE NGA HUMBJEVE TË PRITURA NGA KONTESTET LIGJORE

FKGK ka zhvilluar dhe miratuar metodologjinë për llogaritjen e provizionimeve për humbjet e pritshme që mund të rrjedhin nga kontestet e mundshme ligjore. Metodologjia e provizionimeve ligjore është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të dispozitave ligjore dhe kontraktuale të marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet financiare, donatorët dhe palët e treta, si dhe mbi vlerësimin e rasteve të kërkesave për pagesë të refuzuara ndaj IRF-ve.

QEVERISJA MJEDISORE DHE SOCIALE

PËRKUSHTIMI I FKGK PËR QËNDRUESHMËRI MJEDISORE DHE SOCIALE

Mjedisi dhe shoqëria vazhdojnë të jenë një ndër shtyllat kryesore të misionit institucional të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). Si institucion që mbështet financimin e sektorit privat, FKGK-ja është e përkushtuar në promovimin e financimit të qëndrueshëm dhe minimizimin e rreziqeve potenciale mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet e mbështetura përmes garancive kreditore.

Për të avancuar standardet e qëndrueshmërisë, FKGK-ja ka vazhduar forcimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social, të bazuar në parimet e Qeverisjes Mjedisore, Sociale dhe Korporative. Ky sistem shërben si mekanizëm praktik për menaxhimin e rreziqeve, identifikimin e mundësive për financim të qëndrueshëm dhe harmonizimin me kërkesat e donatorëve dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025, FKGK-ja ka vazhduar integrimin e konsideratave QMS në proceset operative dhe vendimmarrëse, duke avancuar më tej qasjen institucionale ndaj menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social. Në këtë kuadër, FKGK-ja ka bërë përditësime dhe avancime në Politikën për Menaxhimin Mjedisor dhe Social, me qëllim forcimin e kornizës së menaxhimit të rrezikut. Ndryshimet kanë përfshirë përmirësime strukturore të dokumentit, shtimin e përkufizimeve kyçe, qartësimin e roleve dhe përgjegjësisë, forcimin e kërkesave për monitorim dhe raportim, përfshirjen e kërkesave të partnerëve dhe donatorëve në përputhje me marrëveshjet ekzistuese, si dhe zgjerimin e kërkesave për menaxhimin e ankesave dhe kategorizimin e rreziqeve mjedisore dhe sociale.

Ndikimi i FKGK-së në këtë aspekt reflektohet përmes ndikimit indirekt, që rrjedh nga operacionet dhe aktivitetet e brendshme institucionale që kontribuojnë në qëndrueshmëri, si dhe ndikimit direkt, të gjeneruar përmes portofolit të garancive dhe të vlerësuar sipas kriterëve mjedisore dhe sociale në dispozicion.

Përmes kësaj qasjeje, FKGK-ja vazhdon të forcojë rolin e saj si institucion financiar përgjegjës, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm,

tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër dhe promovimin e praktikave të përgjegjshme financiare në vend.

MENAXHIMI I RREZIKUT MJEDISOR DHE SOCIAL


FKGK-ja si institucion garantues vlerëson rreziqet që lidhen me kreditë e garantuara. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të operacioneve dhe identifikimin e rreziqeve të mundshme. Duke kryer vlerësime të plota të rrezikut, FKGK-ja vendos se cilat biznese t'i mbështesë dhe t'i drejtojë ata në zbatimin e masave zbutëse për të minimizuar ndikimet negative. Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) i FKGK-së mbështetet në tri shtylla kryesore:

- (i) kategorizimin e kredive sipas nivelit të rrezikut mjedisor dhe social,
- (ii) zbatimin e listës përjashtuese për aktivitetet që nuk janë të pranueshme për mbështetje, dhe
- (iii) caktimin e personit përgjegjës për QMS, i cili mbikëqyr zbatimin, monitorimin dhe përditësimin e kërkesave të politikës. Forcimi i implementimit të kësaj politike realizohet përmes fuqizimit të vazhdueshëm të këtyre tri shtyllave, duke siguruar monitorim efektiv, përditësim të rregullt të procedurave dhe përputhshmëri me standardet e përcaktuara. Kjo qasje mundëson gjurmimin e progresit, identifikimin e fushave për përmirësim dhe sigurimin që bizneset t'u përmbahen angazhimeve të tyre mjedisore dhe sociale.

Bazuar në këto prime, FKGK-ja ka zhvilluar një sistem për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social të kredive të garantuara, i cili përfshin si shtyllë kryesore kategorizimin e kredive sipas nivelit të rrezikut ambiental. Përmes këtij sistemi aspektet QMS integrohen në procesin e vendimmarrjes, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe me synimin për të minimizuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale.

Gjatë vitit 2025, FKGK-ja ka vazhduar monitorimin e portofolit përmes kategorizimit të ekspozimeve sipas nivelit të rrezikut mjedisor dhe sipas sektorëve ekonomikë. Portofoli i garantuar është kategorizuar në kategori të ndryshme të rrezikut, ku pjesa më e madhe e ekspozimeve vazhdon të klasifikohet në kategorinë me rrezik të ulët mjedisor. Një pjesë më e vogël e portofolit, e shpërndarë gjithashtu nëpër sektorë ekonomikë, është klasifikuar në kategoritë me rrezik mesatar dhe të lartë, të cilat përfshijnë aktivitete me ndikime të moderuara mjedisore dhe sociale, dhe menaxhohen përmes masave adekuate zbutëse dhe monitorimit të vazhdueshëm.


Tabela në vijim paraqet shpërndarjen e portofolit në sektor sipas rrezikut mjedisor deri më 31.12.2025



Si pjesë e menaxhimit të rrezikut klimatik, FKKG-ja ka vazhduar gjithashtu monitorimin e ekspozimeve ndaj sektorëve me intensitet më të lartë të karbonit, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Duke garantuar kreditë, FKKG-ja gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në reduktimin e emetimeve të CO₂

dhe në kursimin e energjisë primare, duke gjeneruar ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë mjedisore dhe efikasitetin energjetik. Gjatë vitit raportues, projektet e mbështetura kanë kontribuar në reduktimin e rreth 6,278.85 tonëve CO₂ dhe në kursime prej 10,515.85 MWh të energjisë primare.

Grafi në vijim paraqet ndikimin në mjedis nga rastet e garantuara në dritaren GROW



Duke u bazuar në këta faktorë, FKKG-ja ka ndërtuar një sistem që vlerëson ndikimin e kredive të garantuara në aspektin mjedisor dhe social duke marrë parasysh aspektet e QMS-së gjatë procesit të vendimmarrjes, në bazë të praktikave më të mira të mundshme dhe me ndikime më të vogla mjedisore dhe sociale.

Për të vlerësuar ndikimin e brendshëm të FKKGsë, janë ndërmarrë masa që të reduktohen gjurmët e karbonit duke zvogëluar konsumin e energjisë elektrike, riciklimin e mbeturinave si dhe përdorimin e taksive elektrike për operacionet. Po ashtu, FKKG-ja ka realizuar trajnime rifreskuese me IRF-të dhe IMF-të në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të kredive të financuara dhe të garantuara nga FKKG-ja.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është zbatimi i politikave të menaxhimit mjedisor dhe social sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Me këtë FKKG-ja ka kufizuar listën e sektorëve dhe aktiviteteve që garantojnë, duke marrë për bazë ndikimin mjedisor dhe social që mund të shkaktohet.

PJESA VI





AKTIVITETET GJATË VITIT 2025

AKTIVITETET E KOMUNIKIMIT DHE RELACIONEVE ME PUBLIKUN GJATË VITIT 2025

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, edhe gjatë vitit 2025 vazhdoi me zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të komunikimit dhe relacioneve me publikun. Komunikimet e FKKG-së, lidhur me misionin, skemat garantuese u zhvilluan përmes aktiviteteve të ndryshme. U inicuan fushata të përbashkëta me IRF-të, për të promovuar dritaret e FKKG-së duke përfshirë sesione informuese për stafin e IRF-ve lidhur me skemat ekzistuese dhe dritaret e reja. Po ashtu, FKKG mbajti ligjerata në institucione të arsimit të lartë, mori pjesë në forume dhe aktivitete me fokus ekonominë dhe financimin, si dhe ishte aktiv në promovimin e dritareve garantuese përmes mediave dhe emisioneve të ndryshme, të cilat janë paraqitur në vijim.

Duke u udhëhequr nga objektivat kryesore të komunikimit—rritja e reputacionit dhe imazhit institucional të FKKG-së, thellimi i angazhimit me palët e interesuara, dhe zgjerimi i njohurive mbi dritaret e garancisë—njësia e komunikimit luajti një rol kyç në mbështetjen e të gjitha njësive gjatë vitit 2025. Përpjekjet tona siguruan konsistencë në mesazhe, përputhje me identitetin institucional dhe koordinim të harmonizuar në të gjitha kanalet e komunikimit.

Gjatë vitit 2025, FKKG organizoi shumë trajnime, punëtori dhe aktivitete shkëmbimi informacioni me institucionet financiare partnere. Këto iniciativa forcan kuptimin mbi produktet e FKKG-së, duke mundësuar që stafi i bankave partnere të promovonte dhe zbatonte në mënyrë efektive skemat e garancisë. Përmes rritjes së njohurive institucionale, këto përpjekje kontribuan në ofrimin më efikas të shërbimeve dhe forcimin e ekosistemit financiar. FKKG gjithashtu zgjeroi prezencën e saj në institucionet arsimore, duke mbajtur pesë ligjerata dhe prezantime për studentët në universitete publike dhe private. Gjatë gjithë vitit 2025, FKKG ishte pjesë e forumeve, konferencave të ndryshme për sektorin, duke prezantuar skemat garantuese si dhe rolin e rëndësishëm të FKKG-së.

24 JANAR 2025

FKKG mirëpriti një delegacion të lartë nga TESKOMB – Unioni Qendror i Sindikatave dhe Kooperativave të Zejtarëve dhe Tregtarëve për Garanci Kreditore në Turqi, njëherit anëtare e AECM. Vizita kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave institucionale, diskutimin mbi veprimtarinë dhe funksionimin e skemave garantuese, si dhe shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve. Delegacioni u prit nga përfaqësues të FKKG-së, si dhe nga Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës.




6 SHKURT 2025

FKKG ishte mysafir në ITP Prizren, ku prezantoi institucionin dhe skemat garantuese para komunitetit të bizneseve. Gjatë këtij aktiviteti, Drejtori Menaxhues i FKKG-së, z. Besnik Berisha, shpjegoi rolin dhe rëndësinë e skemave garantuese, me theks të veçantë në dritaren Startup të dedikuar për ndërmarrjet e reja. Aktiviteti u karakterizua me pjesëmarrje dhe interesim të lartë të bizneseve lidhur me funksionimin e Fondit dhe mundësitë e mbështetjes financiare.



27 SHKURT 2025

FKGK ishte pjesë e diskutimit të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovës.



21 MARS 2025

FKGK ishte pjesë e konferencës së organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shkollës së Frankfurtit për Financa dhe Menaxhim, me rastin e lansimit të nismës "WE Finance Code" për mbështetjen e qasjes në financa për gratë ndërmarrëse. Në kuadër të kësaj konference, Drejtori Menaxhues i FKGK-së, z. Besnik Berisha, ishte pjesë e panelit të diskutimit mbi fuqizimin e ndërmarrjeve të udhëhequra nga gratë dhe mbylljen e boshllëkut financiar.



8 PRILL 2025

FKGK mbajti një ligjeratë në RIT Kosovo, ku u prezantua rëndësia dhe roli i skemave garantuese në mbështetjen e NMVM-ve dhe në zhvillimin ekonomik. Gjatë ligjeratës, studentët u informuan mbi funksionimin e skemave garantuese dhe përfitimet që ato ofrojnë për bizneset, ndërsa ligjerata u mbajt nga znj. Anita Toçi nga FKGK, në kuadër të orëve mësimore të Prof. Fadil Sahiti dhe Prof. Mrika Kotorri.



22 PRILL 2025

FKGK shënoi 9-vjetorin e themelimit, ndërsa në kuadër të Javës së FKGK-së organizoi një aksion vullnetar për pastrimin e ambientit, të ndërlidhur me shënimin e Ditës së Tokës. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me organizatën "Let's Do It – Ta Pastrojmë Kosovën", duke reflektuar angazhimin e Fondit ndaj përgjegjësisë sociale dhe mbrojtjes së mjedisit.



23 PRILL 2025

FKGK shënoi 9-vjetorin e themelimit së bashku me bashkëpunëtorë dhe partnerë institucionalë. Me këtë rast, u theksua roli i Fondit në mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të mesme gjatë nëntë viteve të veprimtarisë, si dhe u shpreh mirënjohje ndaj institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, institucioneve të regjistruara financiare dhe të gjithë partnerëve që kanë kontribuar në këtë rrugëtim.



13 MAJ 2025

FKGK filloi ciklin e ri të trajnimeve për dritaren GROW, të organizuara për institucionet e regjistruara financiare, në bashkëpunim me MACS. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte prezantimi i karakteristikave të reja të dritares GROW dhe rifreskimi i njohurive lidhur me platformën e-Save. Dritarja GROW synon të mbështesë qasjen në financa për NMVM-të, përmes mbështetjes së financimeve në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe efijencës së energjisë.



17 MAJ 2025

FKGK ishte pjesë në takimin vjetor të Asociacionit Evropian të Institucioneve Grantuese (AECM), me pjesëmarrjen e delegacionit të FKGK-së. Gjatë këtij eventi, Kryesuesi i Bordit të FKGK-së, z. Agan Azemi, mbajti një prezantim me titull "Rritja e ndikimit në zhvillim, përmes garancive", duke prezantuar rolin e skemave grantuese në fuqizimin e zhvillimit ekonomik.



19 MAJ 2025

FKGK ishte pjesë e panelit të diskutimit për Dritaren për Investime të Diasporës, ku u diskutua roli i skemave grantuese në mbështetjen e investimeve të diasporës dhe forcimin e qasjes në financa. Përfaqësuesit e FKGK-së prezantuan funksionimin e kësaj dritareje dhe kontributin e saj në zhvillimin ekonomik.



20 MAJ 2025

FKGK ishte pjesë e Forumin Financiar të Kosovës 2025, ku Drejtori Menaxhues i FKGK-së, z. Besnik Berisha, ishte folës në panelin diskutues me temën "Ndërtimi i një të ardhmeje të qëndrueshme financiare: Tranzicioni financiar dhe përtej", duke kontribuar në diskutimet mbi zhvillimin e qëndrueshëm financiar.

26 MAJ 2025

FKGK ishte pjesë e "Euro Mediterranean Guarantee Network (EMGN) Spring Academy 2025", e mbajtur në Stamboll, i përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues, z. Besnik Berisha. Fokusi i kësaj akademie ishte skema garantuese e gjelbër, ku FKGK prezantoi dritaren GROW dhe përvojën institucionale lidhur me dizajnimin, implementimin, veçoritë dhe kriteret kualifikuese të skemave garantuese të gjelbra, si dhe punën dhe të arriturat e institucionit deri më sot.



4 QERSHOR 2025

FKGK organizoi Takimin Vjetor 2025 me përfaqësuesit e Institucioneve të Regjistruara Financiare, me qëllim diskutimin e sfidave të përbashkëta, shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Gjatë takimit u reflektua mbi proceset që ndërlidhen me dritaret garantuese dhe rolin e garancisë së FKGK-së, ndërsa Fondi shprehu mirënjohje ndaj IRF-ve për përkushtimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.



4 QERSHOR 2025

Në kuadër të Takimit Vjetor me IRF-të, FKGK ndau mirënjohje në shenjë vlerësimi për bashkëpunimin profesional dhe kontributin e tyre në zbatimin e skemave garantuese.

Mirënjohjet u ndanë si vijon:

- **Banka Ekonomike** – për miratimin e rastit të parë të kredisë së garantuar në kuadër të skemës garantuese «**Dritarja për Investime të Diasporës**».
- **TEB Banka** – për performancën më të mirë në kuadër të skemës garantuese «**Dritarja Gratë në Biznes**».
- **Banka për Biznes (BpB)** – për performancën më të mirë në kuadër të skemës garantuese «**Dritarja Start-Up**».
- **ProCredit Bank** – për performancën më të mirë në kuadër të skemës garantuese «**Dritarja e Eksportit**».
- **NLB Bank** – për performancën më të mirë në kuadër të skemës garantuese «**Dritarja GROW**».
- **BKT Kosova** – për performancën më të mirë në kuadër të skemës garantuese «**Dritarja Agro**».
- **Raiffeisen Bank** – për shfrytëzimin më të madh të skemës garantuese «**Dritarja Standarde**».

- **KEP Trust** – për bashkëpunimin profesional me FKGK-në.
- **FINCA Kosovë** – për bashkëpunimin profesional me FKGK-në.
- **PriBank** – për bashkëpunimin dhe kyçjen e shpejtë në kuadër të FKGK-së.



18 QERSHOR 2025

FKGK mbajti takimin vjetor me stafin e IRF-ve që merren me kërkesa për pagesa dhe rikthime. Gjatë takimit u prezantua puna e FKGK-së, dritaret garantuese dhe pasqyra e përgjithshme e kërkesave për pagesë dhe rikthime, ndërsa fokusi ishte diskutimi mbi mbarëvajtjen e proceseve që ndërlidhen me këto procedura. FKGK organizon takime të tilla të rregullta dy herë në vit.




25 KORRIK 2025

FKGK zgjeroi bashkëpunimin me KEP Trust përmes nënshkrimit të marrëveshjes për përfshirjen e këtij institucioni në skemat garantuese Dritarja Standarde, Dritarja për Gratë në Biznes dhe Dritarja Start-Up. Bashkëpunimi ndërmjet FKGK-së dhe KEP Trust kishte filluar në mars 2021 me përfshirjen në Dritaren Agro, ndërsa me këtë zgjerim KEP Trust u bë institucioni i parë mikrofinanciar që ofron garanci në kuadër të katër skemave garantuese të FKGK-së, duke rritur mundësitë e qasjes në financa për NMVM-të.



29 KORRIK 2025

FKGK ishte pjesë e panelit diskutues në edicionin e parë të panairit Expo Real Kosova 2025. Gjatë këtij paneli, përfaqësuesja e FKGK-së, znj. Nora Arifi, Menaxhere e Lartë e Portofolit, prezantoi skemën garantuese GROW dhe rolin e FKGK-së në nxitjen e praktikave të qëndrueshme në sektorin financiar. Përmes Dritaresh GROW, Fondi kontribuon në financimin e investimeve në energji eficiente dhe zhvillim të qëndrueshëm,



duke forcuar angazhimin e tij për financimin e gjelbër dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë.

25 GUSHT 2025

FKGK realizoi një vizitë në biznesin Aronica, një shembull i bujqësisë së qëndrueshme dhe inovacionit, i themeluar nga investitorë të diasporës. Biznesi ka përfutur mbështetje financiare përmes Dritaresh për Investime të Diasporës, e cila ka mundësuar zgjerimin e aktivitetit dhe pajisjen me makineri moderne, duke rritur kapacitetet prodhuese. Vizita u zhvillua në prani të përfaqësuesve të lartë institucionale dhe partnerëve financiarë, duke dëshmuar rolin e kësaj skeme në nxitjen e investimeve të diasporës dhe zhvillimin e ndërmarrësisë private në Kosovë.



7 TETOR 2025

FKGK zhvilloi një trajnim për stafin e KEP Trust, në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Trajnimi u fokusua në rolin dhe rëndësinë e skemave të garancisë kreditore në lehtësimin e qasjes në financa për NMVM-të, duke prezantuar dritaret garantuese të FKGK-së, veçoritë e tyre kryesore dhe mënyrën e mbështetjes që ato ofrojnë për institucionet financiare. Në fokus të veçantë ishin skemat garantuese: Dritarja Standarde, Dritarja për Gratë në Biznes dhe Dritarja Start-Up. Përmes aktiviteteve të tilla të ngritjes së kapaciteteve, FKGK



vazhdon të forcojë bashkëpunimin me partnerët dhe të kontribuojë në ndërtimin e një ekosistemi financiar që mbështet bizneset vendore.

7 TETOR 2025

FKGK filloi programin e trajnimeve për marketing digjital për gratë në biznes, me sesionin e parë të mbajtur në Prishtinë. Ky program synon fuqizimin e grave ndërmarrëse në Kosovë përmes zhvillimit të aftësive në marketingun digjital dhe shfrytëzimin e rrjeteve sociale për rritjen e bizneseve të tyre. Trajnimet do të zhvillohen në shtatë qytete të Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicë. Programi financohet nga Suedia, implementohet nga FKGK.



22 TETOR 2025

FKGK zhvilloi një takim strategjik bashkëpunimi me përfaqësues të nivelit të lartë institucional, përfshirë Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Takimi u fokusua në koordinimin ndërinstitucional, diskutimin e prioritetëve strategjike dhe forcimin e bashkëpunimit për avancimin e qasjes në financa dhe stabilitetin financiar.



24 TETOR 2025

FKGK ishte pjesë e panelit të tryezës së diskutimit ku u prezantua raporti "Forcimi i mbështetjes financiare për bizneset në pronësi të grave dhe pakicave etnike në Kosovë", organizuar nga Instituti GAP në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung. Gjatë këtij paneli, drejtori menaxhues i FKGK-së, z. Besnik Berisha, prezantoi kushtet e reja dhe veçoritë e Dritares për Gratë në Biznes, si dhe përkushtimin e institucionit në lehtësimin e qasjes në financa për segmentet më pak të shërbyera.



27 TETOR 2025

FKGK ishte pjesë e takimit OTS të organizuar nga Asociacioni Evropian i Institucioneve Garantuese (AECM), i mbajtur në Paris, me temë "Garancitë kreditore për përfshirjen ekonomike dhe sociale". Gjatë këtij takimi, FKGK prezantoi Dritaren për Gratë në Biznes, me theks të veçantë në komponentën jofinanciare, përfshirë iniciativat për trajnimin e grave në biznes në fushën e njohurive financiare, marketingut digjital dhe komunikimit.




7 NËNTOR 2025

FKGK ishte pjesë e ngjarjes "Women's Entrepreneurship Expo 2025 – Kosovo Satellite Event", të organizuar nga UN Women Kosovo, ku u përfaqësua në panelin diskutues nga znj. **Nora Arifi**, e cila theksoi rolin e FKGK-së në fuqizimin ekonomik të grave përmes garancive kreditore dhe mbështetjes jofinanciare, duke konfirmuar përkushtimin institucional për ndërtimin e një ekosistemi gjithëpërfshirës për gratë në biznes në Kosovë.



10 NËNTOR 2025

FKGK filloi ciklin e trajnimeve për degët e bankave në qytetet kryesore, me qëllim rritjen e njohurive të stafit mbi skemat garantuese dhe veçoritë e reja të dritareve strategjike **Gratë në Biznes, Start-up** dhe **GROW**, ku javën e kaluar u realizua trajnimi me **Banka Ekonomike**, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve të bankave dhe përmirësimin e mbështetjes për bizneset përfituese.



12 NËNTOR 2025

PriBank është bërë partner i plotë financiar i FKGK-së, pas nënshkrimit të marrëveshjes që i mundëson qasje në të gjitha dritaret garantuese me një limit garancie prej 6.5 milionë euro, duke rritur kapacitetin për financimin e NMVM-ve, nxitjen e rritjes së qëndrueshme, eksporteve dhe sipërmarrjes inovative, ndërsa përmes përmirësimit të kushteve në dritaret strategjike GROW, Gratë në Biznes dhe Start-up, ky partneritet forcon më tej ndikimin e FKGK-së në zhvillimin ekonomik të vendit.



17 NËNTOR 2025

FKGK dhe NLB Banka kanë nënshkruar marrëveshje për vazhdimin dhe zgjerimin e Dritares GROW, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet për bizneset që investojnë në efikasitet të energjisë dhe energji të ripërtëritshme, përfshirë rritjen e përqindjes së garancisë në 70%, rritjen e ekspozimit maksimal dhe shumës së kredisë, zgjatjen e afatit të financimit deri në 120 muaj si dhe uljen e tarifave të garancisë, ndërsa ky partneritet, i cili që nga viti 2016 ka mundësuar mbi 51 milionë euro kredi të garantuara, vazhdon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbështetjen e bizneseve në Kosovë.



25 NËNTOR 2025

FKGK dhe Banka Ekonomike nënshkruan marrëveshje për vazhdimin dhe zgjerimin e Dritares GROW, duke ofruar kushte më të favorshme për bizneset që investojnë në efikasitet energjetik dhe energji të ripërtëritshme, përfshirë rritjen e përqindjes së garancisë në 70%, rritjen e ekspozimit maksimal dhe shumës së kredisë, zgjatjen e afatit të financimit deri në 120 muaj si dhe uljen e tarifave të garancisë, ndërsa ky partneritet, që nga viti 2016, ka mundësuar mbi



77 milionë euro kredi të garantuara nga FKGK, duke mbështetur qindra biznese dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.

25 NËNTOR 2025

FKGK mbajti një konferencë për media me ç'rast kumtoi arritjen e një momenti historik në zhvillimin e tij, me portofolin kumulativ të kredive të garantuara që tejkaloi pragun **1 miliard euro**, duke reflektuar rritje të qëndrueshme të qasjes në financa për NMVM-të në Kosovë, me mbi 519 milionë euro garanci të miratuara, mbi 169 milionë euro garanci aktive, më shumë se 20,258 kredi të garantuara dhe rreth 13,000 biznese të mbështetura, arritje kjo e mundësuar falë partneritetit të ngushtë me institucionet e regjistruara financiare dhe mbështetjes së vazhdueshme të donatorëve ndërkombëtarë dhe institucioneve vendore.



27 NËNTOR 2025

FKGK ishte pjesë e Green Business and Industry Summit 2025, i përfaqësuar nga znj. Nora Arifi, Menaxhere e Lartë e Portofolit. FKGK mori pjesë në panelin diskutues të dedikuar për ESG, ku u diskutua roli i sektorit privat në thellimin e pjekurisë ESG, forcimin e gatishmërisë për përputhshmëri dhe përshejtimin e investimeve në zgjidhje me karbon të ulët.



2 DHJETOR 2025

FKGK dhe BKT Kosova nënshkruan marrëveshje për vazhdimin dhe zgjerimin e Dritares GROW, duke ofruar kushte më të favorshme për bizneset që investojnë në efikasitetin e energjisë dhe prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Përmirësimet përfshijnë rritjen e përqindjes së garancisë nga 50% në 70%, rritjen e ekspozimit maksimal kreditor nga 5 në 7 milionë euro, rritjen e shumës maksimale të kredisë nga 1 në 3 milionë euro, zgjatjen e afatit të kredisë deri në 120 muaj, si dhe uljen e tarifave të garancisë. Që nga viti



2016, partneriteti me BKT-në ka mundësuar mbi 131 milionë euro kredi të garantuara nga FKGK, duke mbështetur qindra biznese në Kosovë.

3 DHJETOR 2025

FKGK dhe BpB – Banka për Biznes kanë nënshkruar marrëveshje për vazhdimin dhe zgjerimin e Dritares GROW, duke avancuar kushtet për bizneset që investojnë në efikasitet të energjisë dhe prodhim të energjisë së ripërtëritshme. Marrëveshja parasheh rritjen e përqindjes së garancisë nga 50% në 70%, rritjen e ekspozimit maksimal kreditor nga 5 në 7 milionë euro, rritjen e shumës maksimale të kredisë nga 1 në 3 milionë euro, zgjatjen e afatit të kredisë deri në 120 muaj, si dhe uljen e tarifave të garancisë. Që nga viti 2016, partneriteti



me BpB-në ka mundësuar mbi 158 milionë euro kredi të garantuara nga FKGK, duke kontribuar në mbështetjen e qindra bizneseve në Kosovë.

4 DHJETOR 2025

FKGK mbajti një ligjëratë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, ku prezantoi rëndësinë dhe rolin e skemave garantuese në mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Gjatë ligjëratës, studentët u njohën me funksionimin e skemave garantuese, përfitimet që ato ofrojnë për bizneset, si dhe



ndërlidhjen e tyre me zhvillimin ekonomik dhe forcimin e qasjes në financa.

5 DHJETOR 2025

FKGK mirëpriti një delegacion të nivelit të lartë nga Kredi Garanti Fonu (KGF) – Turkiye, me përfaqësues nga KGF dhe Frankfurt School. Vizita studimore u fokusua në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për zgjerimin e qasjes në financa dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik.



5 DHJETOR 2025

FKGK dhe ProCredit Bank Kosova zgjeruan Dritaren GROW, duke përmirësuar kushtet e financimit për bizneset që investojnë në efikasitetin energjetik dhe energjinë e ripërtëritshme. Përmirësimet mundësojnë financim më të favorshëm, me mbulim më të lartë garancie, limite më të përshtatshme kreditimi, afate më të gjata dhe tarifa më të ulëta. Ky partneritet, ndër vite ka mbështetur qindra biznese në Kosovë përmes kredive të garantuara nga FKGK.



8 DHJETOR 2025

FKGK mbajti një trajnim për stafin e PriBank, pas nënshkrimit të marrëveshjes së re për dritaret strategjike me kushte më të favorshme, duke përfshirë fleksibilitet më të madh, tarifa më të ulëta dhe mbulim më të lartë garancie. Në bashkëpunim me eMAC, trajnimi u fokusua në Dritaren GROW dhe platformën eSAVE, me qëllim rritjen e kapaciteteve për financim të gjelbër, investime të qëndrueshme dhe mbështetjen e bizneseve në tranzicionin drejt efijencës energjetike.



9 DHJETOR 2025

FKGK, përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues z. Besnik Berisha, ishte pjesë e panelit diskutues "Financimi i Tranzicionit të Gjelbër – nga Politikat në Praktikë" në kuadër të Green Finance Day 2025. Gjatë diskutimit u theksua roli i Dritares GROW, si skemë e dedikuar garantuese për financimin e gjelbër, e cila mbështet investimet në efijencë të energjisë, energji të ripërtëritshme dhe projekte të qëndrueshme mjedisore, duke shndërruar objektivat klimatike në rezultate konkrete për bizneset në Kosovë. FKGK kontribuoi në panel



përkrah institucioneve si ProCredit Bank, IFC dhe EBRD, nën moderimin e InstaBuilt.

15 DHJETOR 2025

FKGK ishte pjesë e Konferencës Vjetore të organizuar nga Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA), me temën "Performanca industriale 2025 dhe planet për mbështetjen e NMVM-ve në 2026". FKGK po përfaqësohet nga Drejtori Menaxhues z. Besnik Berisha, i cili është pjesë e panelit diskutues "Shpalosja e potencialit të industrisë vendore: rezultatet 2025 dhe planet 2026", ku po diskutohen zhvillimet kryesore industriale dhe masat mbështetëse për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.



16 DHJETOR 2025

Znj. Klimes, Zyrtare e Vendit për Kosovë në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), realizoi një vizitë në kompaninë TAG, një shembull i suksesshëm i ndërmarrësisë vendore. Vizita u zhvillua së bashku me përfaqësues nga TAG, GIZ Kosovo dhe KfW, si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga TEB ShA dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), duke reflektuar rëndësinë e bashkëpunimit institucional në mbështetje të bizneseve në Kosovë. Biznesi është garantuar përmes Dritares për Investime të Diasporës, duke dëshmuar rolin e partneritetit ndërmjet FKGK, BMZ dhe KfW në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e historive të qëndrueshme të suksesit.



STORIE TË SUKSESIT

GERTI FOODS Sh.p.k. Kur tradita bëhet markë ndërkombëtare

Nga Hasi, një trevë e njohur për mikpritjen dhe trashëgiminë e pasur të gatimit të brumërave, lindi një ide që sot është shndërruar në një histori të vërtetë suksesi. Duke u mbështetur në traditën familjare dhe pasionin për punën, z. Shpejtim Agushaj, së bashku me investitorët nga diaspora, z. Talat Binaj dhe z. Idajet Osmanollaj, themeluan në vitin 2022 kompaninë Gerti Foods Sh.p.k. – me vizionin që tradita hasjane të shndërrohej në një markë moderne e eksportueshme përtej kufijve të Kosovës.



FABRIKË MODERNE ME STANDARDE NDËRKOMBËTARE

Sot, Gerti Foods operon në një fabrikë moderne në Prizren, me sipërfaqe prej 2200 m², të pajisur me makineri të teknologjisë së lartë dhe me një ekip prej 25 punëtorësh profesionistë e të përkushtuar. Çdo ditë, nga kjo fabrikë dalin: krosane të freskëta, tortilla, pite tradicionale, pizza të shijshme, si dhe shumë produkte të tjera që ruajnë shijen autentike dhe cilësinë e lartë për të cilat klientët vendas dhe ndërkombëtarë kanë krijuar besim.

CILËSI DHE SIGURI USHQIMORE

Gerti Foods i kushton rëndësi të veçantë cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

Kjo kompani është e certifikuar me ISO 22000:2018, nga trupa certifikuese me renome ndërkombëtare TÜV Nord, duke garantuar standarde të larta në çdo hap të prodhimit.

EKSPANSIONI NË TREGJE NDËRKOMBËTARE

Falë përkushtimit dhe vizionit të qartë, produktet e Gerti Foods tashmë gjenden jo vetëm në tregun e Kosovës, por eksportohen me sukses edhe në Shqipëri, Austri dhe Slloveni, Gjermani duke i dhënë kompanisë një dimension të ri zhvillimi dhe afirmimi ndërkombëtar.

ROLI I MBËSHTETJES FINANCIARE

Ky sukses nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e duhur financiare. Gerti Foods është një nga përfutuesit e Skemës Garantuese në kuadër të Dritares së Eksportit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK). Përmes kësaj skeme garantuese, kompania siguroi kredinë e nevojshme për të bërë investimet kyçe. Siç shprehet themeluesi, z. Shpejtim Agushaj: “Mbështetja nga FKGK na mundësoi të realizojmë investimet që i dhanë hov kompanisë sonë. Ishte një ndihmë vendimtare që na hapi rrugën drejt tregjeve ndërkombëtare.” Me këto fonde, kompania investoi në pajisje moderne dhe sisteme shokngrirjeje, të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen e cilësisë, freskisë dhe vlerave ushqyese të produkteve. Kjo teknologji siguron që produktet ta ruajnë cilësinë në maksimum deri në momentin kur arrijnë tek konsumatori final, duke garantuar të njëjtin standard cilësor si në ditën e prodhimit.

NJË MODEL FRYMËZUES

Gerti Foods Sh.p.k. është më shumë se një prodhues i brumërave – është një shembull i gjallë i fuqisë së traditës, vizionit dhe mbështetjes së institucioneve vendore. Është një model suksesi për të gjithë ata që besojnë se ëndrrat e mëdha mund të lindin nga një vend i vogël dhe të shndërrohen në marka të fuqishme ndërkombëtare.

Gerti Foods Sh.p.k. – Traditë që udhëton përtej kufijve!

SWISS HOME STORE

Transformues i prodhimitarisë në Kosovë

Në qytetin e bukur të Prizrenit, më saktësisht në lagjen Arbanë, ishim në vizitë tek biznesi **Swiss Home Store**, që paraqet një histori vizionare, inovacioni dhe rritjeje.



Swiss Home Store u themelua në vitin 2016, kur një investim i përbashkët familjar nga Zvicra pa një mundësi për të hyrë në tregun në rritje të Kosovës. Me shumë përkushtim, disiplinë dhe punë, ata krijuan një biznes të specializuar në prodhimin e roletave të aluminit, duke ofruar cilësi të lartë dhe inovacion.

Ambicia e tyre nuk ishte vetëm të prezantonin produkte superiore, por edhe të krijojnë vende pune dhe të kontribuonin në ekonominë vendase.

Për ta sjellë në jetë vizionin e tyre, investitorët familjarë bënë një investim të konsiderueshëm në makineri moderne, duke siguruar prodhim me kapacitet të lartë dhe saktësi maksimale.

Kjo teknologji e sofistikuar u mundësoi atyre të plotësojnë kërkesën në rritje për roletave kualitative dhe moderne, të qëndrueshme, për tregun e Kosovës dhe më gjerë.

Pavarësisht nga investimet vetanake, sigurisht që duhej financim për të mbuluar koston e blerjes së maqinës që do t'u mundësonte rritjen e shpejtë të biznesit.

Përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), ata mundën të kapërcejnë hendekun financiar, duke siguruar burimet e nevojshme për të blerë maqinën.

Sot, Swiss Home Store është një shembull i shkëlqyer se si investimet strategjike dhe mbështetja financiare mund të nxisin suksesin.

Biznesi është rritur për t'u bërë një lojtar kyç në treg, duke ofruar produkte me cilësi të lartë. Objekti i tyre shumë i avancuar i prodhimit, ju mundëson të përmbushin porositë e që mbulojnë komplet tregun e Kosovës në mënyrë efikase, duke ruajtur çmimet konkurruese dhe standardet e jashtëzakonshme të cilësisë.

Më shumë se një biznes, sipërmarrja e tyre është bërë një burim punësimi dhe zhvillimi i aftësive për fuqinë punëtore vendore, duke nxitur rritjen ekonomike dhe inovacionin industrial në Kosovë.

Udhëtimi i tyre është një dëshmi e fuqisë së ndërmarrësisë, investimeve strategjike dhe ndikimit të institucioneve financiare si FKGK në aftësimin e bizneseve të lulëzojnë.

Ndërsa vazhdojnë të rriten dhe të inovojnë, historia e tyre e suksesit shërben si frymëzim për ndërmarrësit e tjerë që kërkojnë të investojnë dhe të ndërtojnë një të ardhme të begatë në Kosovë.

PJESA VII





PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e
përfunduar më 31 dhjetor 2025**

PËRMBAJTJA

	Page
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	3
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	4
Shënimet e Pasqyrave Financiare	5 – 50

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e drejtorve të FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE (më poshtë "Fondi"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimi dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë informacionin material të politikave të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëngjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në atë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare në raportin tonë. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka dhënë një opinion të pa-modifikuar më 29 prill 2025.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likuidojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Fondit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Fondi të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k.

Ernst & Young Kosovo

29 prill 2026

Prishtinë, Kosovë

Mario Vangjeli

Auditor Ligjor



Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)

		Më 31 dhjetor 2025 (EUR)	Më 31 dhjetor 2024 (EUR)
	Shënime		
PASURITË			
Prona, impiantet dhe pajisjet	9	48,875	16,813
Pasuritë e paprekshme	10	35,246	17,362
Pasuritë me të drejtë përdorimi	8	125,203	3,173
Gjithsej pasuritë afatgjata		209,324	37,348
Depozitat	6	73,473,102	69,444,691
Investimet në letra me vlerë	7	30,888,962	29,521,232
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	5	532,765	350,079
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	10,673,850	11,772,869
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		115,568,679	111,088,871
GJITHSEJ PASURITË		115,778,003	111,126,219
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Kapitali	13	97,559,216	97,300,921
Fitimi i akumuluar		7,538,053	4,360,451
Fitimi i vitit		4,137,330	3,177,602
Gjithsej ekuiteti		109,234,599	104,838,974
Rezervat e humbjeve nga garancionet e kredive	19	4,445,695	4,332,317
Të hyrat e shtyra	11	360,335	627,575
Detyrimet e qirasë	8	100,904	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		4,906,934	4,959,892
Akrualet e tarifës së Garancisë	12	1,362,222	1,188,285
Të hyrat e shtyra	11	235,863	111,798
Shpenzime akruale		11,380	23,599
Detyrimet e qirasë	8	27,005	3,671
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		1,636,470	1,327,353
Gjithsej detyrimet		6,543,404	6,287,245
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI		115,778,003	111,126,219

Autorizuar për publikim nga menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tij më 23 prill 2026

Besnik Berisha
Drejtor Menaxhues



Vjosa Balaj
Menaxhere e Lartë e Financave

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 50 përbëjnë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënime	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2025 (EUR)	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2024 (EUR)
Të hyrat			
Tarifat e garancioneve	14	2,643,790	2,376,782
Të hyra nga interesi	15	3,323,871	2,271,078
Të hyra tjera	16	408,983	235,882
Gjithsej të hyrat		6,376,644	4,883,742
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	17	(397,685)	(285,458)
Shpenzimet operative	18	(279,237)	(152,112)
Shpenzimet e zhvlerësimit	9,10	(23,452)	(28,644)
Shpenzimet e zhvlersimit të drejtës përdorimi	8	(24,612)	(19,038)
Neto provizioni për humbje nga garancionet	19	(1,525,617)	(1,106,346)
Neto provizioni për humbje nga pasuritë tjera	19	17,585	(113,591)
Gjithsej shpenzimet		(2,233,018)	(1,705,189)
Fitimi bruto		4,143,626	3,178,553
Shpenzimet e interesit të drejtës përdorimit të pasurisë		(6,296)	(951)
Neto fitimi për vitin		4,137,330	3,177,602
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		4,137,330	3,177,602

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 50 përbëjnë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuilet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali (EUR)	Fitimi i akumuluar (EUR)	Fitimi i vitit (EUR)	Gjithsej (EUR)
Bilanci më 1 janar 2024	76,932,511	4,360,451	-	81,292,962
Neto fitimi për vitin	-	-	3,177,602	3,177,602
Kapitali i paguar	20,368,410	-	-	20,368,410
Bilanci më 31 Dhjetor 2024	97,300,921	4,360,451	3,177,602	104,838,974
Neto fitimi për vitin	-	-	4,137,330	4,137,330
Kapitali i paguar	258,295	-	-	258,295
Bilanci më 31 Dhjetor 2025	97,559,216	4,360,451	7,314,932	109,234,599

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 50 përbëjnë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditor
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025
(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)

		Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2025	Viti i përfunduar më 31 dhjetor 2024
		(EUR)	(EUR)
	Shënime		
Aktivitetet operative			
Neto profiti për vitin, para tatimit		4,137,330	3,177,602
<i>Rregullimet për:</i>			
Humbjet e pritshme nga kreditë e garancioneve	19	1,525,617	1,106,346
Humbjet e pritshme nga kreditë e pasurive të tjera financiare	19	(17,587)	113,591
Amortizimi i pasurive të së drejtës së përdorimit	8	24,612	19,038
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimiit	9,10	23,450	28,644
Të hyrat nga interesi	15	(3,323,871)	(2,271,078)
Shpenzimet nga interesi	8	6,296	951
Humbja nga veprimtaria para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		2,375,847	2,175,094
Rritja e të arkëtueshmeve tregtare dhe të arkëtueshmeve të tjera		(182,686)	(14,428)
Zvogëlimi në shpenzimet akruale		(12,217)	(77,835)
Zvogëlimi në të hyrat e shtyra		(143,175)	(90,467)
Rritja/(Zvogëlimi) i akrualeve së tarifës së Garancisë		173,937	57,946
Dëmet e paguara		(1,412,239)	(1,340,282)
Paraja neto e gjeneruar në aktivitetet operative		799,467	710,028
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Rritja (Zvogëlimi) i depozitave		(2,900,000)	(13,355,200)
Rritja (Zvogëlimi) i investimeve në letra me vlerë		(1,337,376)	(6,576,517)
Blerja e pronave dhe pajisjeve	9,10	(73,398)	(2,437)
Interesi i arkëtuar		2,200,629	1,989,158
Interesi i paguar		(6,296)	(951)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(2,116,441)	(17,945,947)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesa e detyrimeve të qerasë		(22,404)	(21,249)
Rritja/(Zvogëlimi) e kapitalit		258,295	20,368,410
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		235,891	20,347,161
Rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parasë gjatë vitit		(1,081,083)	3,111,242
Paraja dhe ekuivalentët e parasë, fillimi i vitit		11,779,003	8,687,761
Paraja dhe ekuivalentët e parasë, fundi i vitit		10,697,920	11,799,003

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 50 përbëjnë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është një institucion i pavarur zhvillimor i themeluar për të përmirësuar qasjen në financa për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në Kosovë. FKGK e përmbush mandatin e tij duke ofruar garancione të pjesshme kreditore për institucionet financiare partnere, duke ndarë kështu riskun kreditor për kreditë e kualifikuara të NMVM-ve.

Përmes këtij mekanizmi të ndarjes së riskut, FKGK lehtëson qasjen në financa për NMVM-të, përfshirë ndërmarrjet me modele biznesi të qëndrueshme, por me kolateral të kufizuar, ato që perceptohen me risk të lartë kreditor ose me mungesë të historisë kreditore. Duke vepruar kështu, FKGK promovon përfshirjen financiare dhe kontribuon në rritjen e ndërmarrësisë, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në Republikën e Kosovës.

FKGK është themeluar në janar të vitit 2016, përmes një nisme të përbashkët të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), KfW-së dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK). Themelimi dhe operimi i tij rregullohen nga Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (Ligji Nr. 05/L-057, në vijim: LFKGK). Ligji e përcakton FKGK-në si një entitet juridik të veçantë, të dallueshëm nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti, duke definuar mandatin, autoritetin, kornizën e qeverisjes, fushëveprimin operativ, si dhe procedurat për lëshimin e garancioneve kreditore. FKGK ka filluar operimet e pavarura nën strukturën e vet menaxheriale më 10 qershor 2017. Numri fiskal identifikues i FKGK-së është 601642061.

FKGK operon sipas një modeli garancie të mbështetur nga kapitali vetanak. Baza e tij kapitale përbëhet nga donacionet dhe kontributet grante nga QRK, USAID dhe KfW, si dhe fitimet e pashpërndara të akumuluar që nga fillimi i operimeve të FKGK-së. Kapitali fillestar i FKGK-së është kontribuar nga QRK në shumën 3.0 milionë euro përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nga USAID në shumën 5.79 milionë euro dhe nga KfW në shumën 2.0 milionë euro.

Më pas, KfW ka dhënë kontribute shtesë për të mbështetur skema dhe programe specifike të garancioneve, duke përfshirë 11.5 milionë euro për krijimin e Dritares Agro (një skemë garancie kredie e dizajnuar për të mbështetur investimet në sektorin bujqësor), 5.0 milionë euro për mbështetjen e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, dhe 5.6 milionë euro për financimin e Dritares së Gjellbër – GROW.

Kontributet shtesë kapitale nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë financuar përmes marrëveshjeve të mbështetura nga Banka Botërore nën projektin “Forcimi i Sektorit Financiar në Kosovë”, në shumën prej 21.4 milionë euro, dhe pjesërisht përmes Bankës Evropiane të Investimeve (BEI) nën projektin “Reagimi ndaj COVID-19 për NMVM-të në Kosovë”, në shumën prej 40.0 milionë euro.

Në përputhje me Nenin 10 të LFKGK-së, kapitali minimal statutor i FKGK-së është 300,000 euro.

Përveç kapitalit të vet, FKGK përdor edhe skema ri-garancie të ofruara nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Zhvillimor (Sida), Fondi Evropian i Investimeve nën Programin COSME – Skema e Garancioneve së Huave (LGF), si dhe nga Korporata Ndërkombëtare e Financimit për Zhvillim e SHBA-së (DFC).

FKGK ka nënshkruar Marrëveshjen e saj të parë të Garancioneve me Sida, të përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë, më 6 dhjetor 2017, e cila u pasua nga një marrëveshje e dytë më 30 nëntor 2023. Marrëveshja e Garancioneve me Fondin Evropian të Investimeve nën Programin COSME – LGF u nënshkrua më 14 maj 2019, ndërsa Marrëveshja e Garancioneve me DFC u nënshkrua më 11 maj 2022.

1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)

Këto marrëveshje të ri-garancioneve forcojnë kapacitetin e FKGK-së për mbajtjen e riskut, rrisin efektin levë të kapitalit dhe zmadhojnë potencialin e përgjithshëm për lëshimin e garancioneve, duke mundësuar njëkohësisht kushte më të favorshme për institucionet financiare partnere.

Deri më 31 dhjetor 2025, FKGK ka garantuar gjithsej 1.04 miliardë euro, duke mbuluar 20,790 kredi individuale. Portofoli aktiv i garancioneve kreditore aktualisht arrin në 179.5 milionë euro. Që nga themelimi i tij, rreth 12,767 ndërmarrje private kanë përfutur, të paktën një herë, nga dritaret e garancioneve kreditore të FKGK-së. Këto shifra dëshmojnë rolin e rëndësishëm të FKGK-së në lehtësimin e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e rritjes së bizneseve dhe promovimin e përfshirjes financiare në Kosovë.

Organet drejtuese të FKGK-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKGK-së dhe ofron udhëheqje strategjike si dhe mbikëqyrje mbi institucionin.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga shtatë anëtarë:

- Një anëtar ex-officio i emëruar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Republikës së Kosovës;
- Një anëtar ex-officio i emëruar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës;
- Katër anëtarë të pavarur të emëruar nga donatorët; dhe
- Drejtori Menaxhues i FKGK-së, si anëtar ex-officio me të drejtë vote.

Në përputhje me mandatin e tij ligjor, FKGK është përgjegjës për:

- a. Lëshimin e garancioneve kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve;
- b. Përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe regjistrimin e institucioneve financiare të kualifikuara;
- c. Përcaktimin e kushteve dhe termave të mbulimit të garancioneve kreditore;
- d. Caktimin dhe miratimin e tarifave të garancioneve;
- e. Menaxhimin dhe investimin e pasurive të FKGK-së në përputhje me LFKGK-në;
- f. Shqyrtimin dhe shlyerjen e kërkesave për garancione të paraqitura nga institucionet financiare të regjistruara, në përputhje me politikat përkatëse dhe marrëveshjet e garancioneve; dhe
- g. Kryerjen e funksioneve të tjera sipas përcaktimeve të LFKGK-së.

2. INFORMACION MBI POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të përcaktuara nga IFRS për secilin lloj pasurie, detyrimi, të ardhure dhe shpenzimi. Bazat e matjes përshkruhen më hollësisht në shënimin vijues.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike kontabile. Ajo kërkon gjithashtu që menaxhmenti të ushtrojë gjykim gjatë zbatimit të politikave kontabile të FKGK-së. Fushat ku janë bërë gjykime dhe vlerësime të rëndësishme gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe efektet e tyre zbulohen në shënimin 3.8.

2. INFORMACION MBI POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

- **IAS 21 – Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor: Mungesa e Këmbyeshmërisë (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025. Ndryshimet specifikojnë se si një entitet duhet të vlerësojë nëse një valutë është e këmbyeshme dhe se si duhet të përcaktojë një kurs këmbimi të çastit kur këmbyeshmëria mungon. Valuta konsiderohet e këmbyeshme në një valutë tjetër kur një entitet është në gjendje të marrë valutën tjetër brenda një periudhe kohore që mundëson një vonesë normale administrative dhe nëpërmjet një tregu ose mekanizmi këmbimi në të cilin një transaksion këmbimi do të krijonte të drejta dhe detyrime të zbatueshme. Nëse valuta nuk është e këmbyeshme në valutë tjetër, entiteti duhet të vlerësojë kursin e këmbimit në datën e matjes. Objektivi i entitetit në vlerësimin e kursit të këmbimit të çastit është të pasqyrojë kursin me të cilin do të ndodhte një transaksion i rregullt këmbimi në datën e matjes midis pjesëmarrësve të tregut në kushtet ekonomike mbizotëruese. Ndryshimet vënë re se entiteti mund të përdorë një kurs këmbimi të vëzhgueshëm pa rregullim ose një teknikë tjetër vlerësimi. Ndryshimet nuk kishin ndikim material në pasqyrat financiare të Entitetit.

Standardet e nxjerra por ende jo efektive dhe të pa miratuara herët

- **SNRF 9 Instrumentet financiare dhe SNRF 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet - Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare (Ndryshimet)**

Në maj 2024, BSNK publikoi ndryshime në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare të cilat ndryshuan SNRF 9 Instrumentet financiare dhe SNRF 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet dhe ato janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2026 me aplikim të mëhershëm të lejuar.

- **SNRF 9 Instrumentet financiare dhe SNRF 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet - Kontratat që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra (Ndryshimet)**

Në dhjetor 2024, BSNK-ja publikoi ndryshime të synuara për një pasqyrim më të mirë të Kontratave që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra, të cilat ndryshuan SNRF 9 Instrumentet financiare dhe SNRF 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet dhe ato janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2026 me aplikim të mëhershëm të lejuar.

- **Përmirësime vjetore të standardeve të kontabilitetit të SNRF-së – Vëllimi 11**

Në korrik 2024, BSNK-ja publikoi përmirësimet vjetore të standardeve të kontabilitetit të SNRF-së – Vëllimi 11. Entiteti duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026 ose pas kësaj date. Aplikimi më i hershëm është i lejuar. Entiteti duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2026 ose pas kësaj date. Përmirësimet vjetore të standardeve të kontabilitetit të SNRF-së – Vëllimi 11, përfshijnë ndryshime në SNRF 1, SNRF 7, SNRF 9, SNRF 10 dhe SNK 7. Këto ndryshime synojnë të sqarojnë formulimin, të korrigjojnë pasojat e vogla të paparashikuara, mangësitë ose konfliktet midis kërkesave në standarde.

2. INFORMACION MBI POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1.1 Standardet e nxjerra por jo ende efektive dhe të pa miratuara herët (vazhdim)

- **SNRF 18 Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare**

SNRF 18 prezanton kërkesa të reja për paraqitjen brenda pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Ai kërkon që një entitet të klasifikojë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në njërin nga pesë kategoritë: operacionale; investuese; financuese; tatimet mbi të ardhurat; dhe operacionet e ndërprera. Këto kategori plotësohen nga kërkesat për të paraqitur nën-totalet dhe totalet për 'fitimin ose humbjen operative', 'fitimin ose humbjen para financimit dhe tatimeve mbi të ardhurat' dhe 'fitimin ose humbjen'. Ai gjithashtu kërkon zbulimin e masave të performancës të përcaktuara nga menaxhimi dhe përfshin kërkesa të reja për agregimin dhe çagregimin e informacionit financiar bazuar në 'rolet' e identifikuar të pasqyrave financiare kryesore dhe shënimeve shpjeguese. Përveç kësaj, ka ndryshime pasuese në standarde të tjera kontabël. SNRF 18 hyn në fuqi për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027, me aplikim të hershëm të lejuar. Aplikimi retrospektiv është i detyrueshëm si në pasqyrat vjetore ashtu edhe në ato ndërmjetëse. Ndryshimet do të ndikojnë në paraqitjen e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Entiteti do të duhet të riklasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë tarifat e komisioneve, të ardhurat nga interesi, amortizimin dhe provizionet, në kategoritë e reja të detyrueshme të prezantuara nga SNRF 18, si dhe të paraqesë nën-totalet e reja të kërkuara si 'fitimi operativ'. Ndikimi kufizohet vetëm në strukturën dhe shpalosjen e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

- **SNRF 19 Filialet pa llogaridhënie publike: Shpalosjet (duke përfshirë ndryshimet).**

Në maj 2024, BSNK-ja publikoi SNRF 19 - Filialet pa llogaridhënie publike: Shpalosjet, dhe në gusht 2025, BSNK-ja publikoi ndryshimet në SNRF 19. SNRF 19 (duke përfshirë ndryshimet) hyn në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2027 ose më pas, me aplikim të lejuar më herët.

- **Amendamenti në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta:**

Shitja ose Kontributi i pasurive në mes të një investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Në dhjetor 2015, BSNK-ja shtyu datën e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi për një kohë të pacaktuar në pritje të rezultatit të projektit të saj kërkimor mbi metodën e ekuitetit të kontabilitetit

